

I. Rregulla për organizimin e një Loje-Plan mbi BE në Evropën Juglindore me temë „Evropa në një formë të re“

1. Kohëzgjatja dhe rrjedha e Lojës-Plan

Formati i Lojës-Plan, që ka treguar praktikisht të jetë i suksesshëm për Evropën Juglindore, zgjat 2 ditë. Për arsye praktike rekomandohet të realizohet në fundjavë (të shtunën dhe të djelën). Arsyet për këtë janë:

- Drejtuesit e Lojës-Plan, që janë në marrëdhënie pune, nuk duhet të marrin ditë pushimi ekstra
- Nxënësit pjesëmarrës nuk duhet të marrin leje nga mësimi
- Kohët e udhëtimit mund të organizohen dhe menaxhohen më lehtë
- Hapësirat në institucione politike si p.sh. bashki, parlamente apo seli të qeverive janë zakonisht të lira (mangësi: është e vështirë të sigurosh ndihmën e një administritori ndërtesë në dite fundjave.)

E megjithatë, natyrtisht është e mundur, që Loja-Plan të ofrohet në një format tjetër apo në kuadër të një aktiviteti tjetër. Po kështu edhe kohëzgjatja e Lojës-Plan mund të ndryshojë. Por periudha kohore e sipërpërmendur është provuar të jetë e suksesshme.

Si e suksesshme është provuar të jetë edhe struktura e mëposhtme, në vija të përgjithshme:

Dita 1

- 9:30 Fillimi. Mbërritja dhe regjistrimi i pjesëmarrësve
- 10:00 Përshëndetja dhe prezantimi i drejtuesve të lojës
- 10:30 Prezantimi i programit të përgjithshëm
- 10:45 Njohuri hyrëse në Bashkimin Evropian
- 12:00 Prezantimi i rrjedhës së Lojës, ndarja e roleve, leximi i profileve të roleve
- 13:00 Njohja me parimet dhe rregullat, hapja e Lojës-Plan
- 13:15 Fjala e Kryetarit të Komisionit
- 13:30 Dreka
- 14:30 Bëhen kërkesat për anëtarësim dhe i dorëzohen Këshillit (i cili ia përcjell EP dhe EK)
- 15:30 Kërkesat për anëtarësim përpunohen në tre institucionet, në mënyrë që të diskutohet në mënyrë paralele me shtetet aplikuese
- 15:30 Institucionet zhvillojnë bisedime me aplikuesit
- 16:45 Pushim
- 17:00 Institucionet këshillojnë në lidhje me aplikimet duke u bazuar në Kriteret e Kopenhagenit
- 17:30 EP dhe EK shkruajnë pozicionet e tyre në lidhje me dhënien e mundshme të statusit të kandidatit dhe ia përcjellin këto Këshillit, i cili konsultohet
- 18:00 bëhet një përmbledhje e rrjedhës së deritanishme dhe jepen shpjegime rreth ditës së ardhshme

Dita 2

- 9:00 Mbërritja e pjesëmarrësve dhe fillimi
- 9:15 Përshëndetje, përmbledhje e rrjedhës së programuar të ditës
- 9:30 Këshilli merr vendimin në lidhje me statusin e kandidatit
- 10:00 Konferencë shtypi, njoftimi i vendimeve
- 10:15 Pushim

- 10:30 Bisedime nga ana e Këshillit dhe e EK me kandidatët për anëtarësim Vendim unanimit në Këshill, Parlamenti vendos me shumicë votash
- 12:00 Dreka
- 13:30 Njoftimi rreth anëtarëve të rinj të BE, nënshkrimi i marrëveshjeve dhe Konferencë shtypi
- 14:00 Pushim
- 14:30 Vlerësimi dhe shpërndarja e certifikatave të pjesëmarrjes
- 15:30 Mbyllja e aktivitetit

2. Vendi i aktivitetit dhe ambientet

Për pjesëmarrësit në Lojën-Plan është shumë tërheqës fakti, që Loja zhvillohet në ambientet e institucioneve politike – bashki, parlamente etj. Atje është edhe më e thjeshtë për ta vendosur veten në rolin e politikanëve dhe politikaneve aktivë. Pikërisht për të rinjtë është shumë argëtuese të jenë në vende autentike, që për ta zakonisht janë (ende) të paarrtshëm dhe që më së shumti i njohin vetëm nga televizori dhe shtypi.

Shfrytëzimi i ndërtesave të tilla duhet të kërkohet me kohë pranë zyrës apo personit kompetent, të paktën 6 deri 8 javë përpara aktivitetit të planifikuar. Gjëja më e thjeshtë është kërkesa zyrtare nga organizata përkatëse zbatuese, vecanërisht sqarime duhet të merren rreth informacioneve praktike.

E megjithatë përpara dorëzimit të kërkesës rekomandohet të zhvillohet një bisedë personale me zyrën apo personin përgjegjës, gjatë të cilës duhen sqaruar detaje praktike:

- A mund të sillen pije në ndërtesë?
- A mund të vihet në dispozicion ndonjë mensë e institucionit për të ngrënë? Nëse po, sa do të kushtonte?
- A lejohet që dreka të serviret nga një firmë Catering në ndërtesë?
- A ka rregulla dhe kontrole sigurie? A duhet që pjesëmarrësit të sjellin dokumenta identifikimi me vete?
- A mund të financojë ky institucion në rast se nevojitet bashkëpunimin e personelit?
- Sa të përpikta janë oraret e hapjes së ndërtesës?
- A janë të disponueshme aparatet teknike gjatë fundjavës, si p.sh. mikrofonat, fotokopjet etj?
- A ka një rregullore të brendshme e cila duhet të respektohet?

Kërkesa duhet të ketë në përmbajtje këto pika:

- Cili është lloji i projektit (edukim politik) dhe sa persona pritet të vinë?
- Cila është organizata zbatuese dhe kush është financuesi?
- Sa ambiente nevojiten dhe cilat?
- Cila është ndihma që pritet nga institucioni ku do të zhvillohet aktiviteti?
- Cilat materiale dhe aparate do të sillen me vete?
- Cilat janë marrëveshjet gojore?

Rekomandohet me forcë, që të merret në kohën e duhur miratimi me shkrim dhe të mos kufizoheni vetëm në premtimet me gojë. Në këtë miratim duhet të jenë të listuara edhe pikat e sipërpërmendura në kërkesë.

Në ambiente të vecanta për Lojën-Plan nevojitet:

- Sallë plenare ose sallë e madhe mbledhjesh për të gjithë pjesëmarrësit në plenum
- Sallë mbledhjesh për Këshillin

- Sallë mbledhjesh për parlamentin, nëse salla plenare është shumë e madhe ose e papërshtatshme
- Një dhomë më e vogël pune për Komisionin Evropian
- Grupe karrigesh/kolltuqesh në Lobby ose në korridor ose një dhomë më e madhe për delegacionet e vendeve që kërkojnë anëtarësimin
- Një dhomë e vogël pune për mediat

3. Rekrutimi dhe regjistrimi i pjesëmarrësve

Loja-Plan përshtatet për nxënës të klasave të larta të të gjitha shkollave dhe për studentë të viteve të para nga universitete dhe degë të cdo lloji. Nuk është e nevojshme që pjesëmarrësit të kenë para-njohuri.

Pozitive ka qenë vetëregjistrimi vullnetar i pjesëmarrësve në Lojën-Plan, pasi pikërisht ata që vendosin me dëshirë të marrin pjesë, janë edhe më të motivuarit. Kusht themelor në këtë kontekst do të ishte gjithsesi një informim i kujdesshëm në lidhje me Lojën-Plan, pasi kjo metodë nuk është e njohur në vendet e Evropës Juglindore.

Më me efekt duket se ka qenë vizita në orët e mësimi nëpër shkolla apo seminare në univeristete, ku projekti është përshkruar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një person, i cili ka patur përvojën e vet praktike me Lojën-Plan.

Regjistrimi mund të realizohet me një formular aplikimi, në të cilin të hidhen emri, mbiemri, adresa email, numri i telefonit dhe klasa. Nëse mendohet të krijohet karakteri i një konkursi, organizatori mund të shpjegojë për shembull në kushtet themelore që duhen përmbushur që aplikanti duhet të shkruajë një ese të shkurtër rreth temës: Cfarë pres unë nga Bashkimi Evropian. Kjo ese mund të vlerësohet më pas sipas kriterëve të vendosura më parë. Nëse ka një numër të madh aplikimesh, mund të përzgjidhen ata që kanë paraqitur esenë më të mirë.

Pjesëtarëve të zgjedhur u duhet dhënë në kohën e duhur informacioni i mëposhtëm:

- Data dhe koha (fillimi dhe mbarimi) i aktivitetit
- Vendi i takimit ditën e parë
- Nëse duhen, edhe dokumenta identifikimi
- Udhëzim, sipas të cilit nuk janë të nevojshme njohuri të mëparshme në lidhje me temën
- Lutje për paraqitje të përshtatshme në veshje, ngjashëm me politikanë
- Njoftim i detyruar për pjesëmarrjen

Regjistrimi i pjesëmarrësve:

Organizatorët e Lojës-Plan duhet të njohin që në fillim numrin e saktë të pjesëmarrësve, në mënyrë që të mund të organizojnë mirë ndarjen e roleve. Krahas kësaj shumë sponsorizues kërkojnë edhe listë-prezencat me nënshkrimet përkatëse; ndaj rekomandohet të vihet një tryezë në hyrje të institucionit, ku të jenë vendosur listat e pjesëmarrësve me emrat e të regjistruarve, në të cilat pjesëmarrësit, që hyjnë në ndërtesë duhet të hedhin nënshkrimet e tyre.

4. Organizimi i drekave dhe pushimeve

Për aktivitetin dyditor të Lojës Plan duhen planifikuar dy dreka për lojtarët. Nëse numri i pjesëmarrësve është i madh rekomandohet të angazhohet një firmë Catering, e cila të mund të servirë një bufe dreke të ngrohtë në ndërtesë, nëse kjo gjë është miratuar më parë.

Nëse diku afër gjendet një restorant i përshtatshëm, duhet biseduar më parë për të porositur një menu të njësuar me një cmim të përgjithshëm, duke qenë se mungon koha për të porositur a la carte në mënyrë individuale.

Gjatë Lojës Plan duhet të vihen në dispozicion pije ose gjatë kohës së pushimit ose në sallat e lojës. Kur flet dhe mendon shumë ke etje!

Drejtnesit e skuadrës duhet të udhëzojnë lojtarët, që pushimi i drekës dhe pushimet e shkurtra nuk janë shëputje nga Loja Plan po – ashtu si edhe në jetën reale politike – duhen shfrytëzuar për biseda informale dhe lobbying. Lojtarët duhet t'i kalojnë pushimet duke mbetur brenda rolit të tyre, pra t'i drejtohen njëri-tjetrit me emrat e lojës dhe me „JU“.

5. Përgatitja e materialeve, aparateve teknike dhe përshkrimet e roleve

Organizatorët duhet të caktojnë një person për përgatitjen dhe sigurimin e materialeve, i cili do të mbajë edhe gjatë zhvillimit të Lojës të gjithë përgjegjësinë për administrimin e tyre.

Në dispozicion mund – jo domosdoshmërisht – të vihen këto aparate (teknike):

- LCD-Projektor (Beamer) dhe Laptop për projektimin e pikave kryesore të aktiviteteve në plenum.
- Alternativa: Overhead-Projektor ose formate të mëdha letre /Flipcharts, mbi të cilat të shkruhen fjalët kryesore (në formën e një gazete muri)
- Kamera dixhitale dhe/ose aparat fotografik
- Fotokopjuese (nëse nuk ndodhet në institucion paraprakisht apo nuk ka ndonjë Copyshop afër ndërtesës)

Materialet:

- Formate të mëdha letre
- Një pako me letra të bardha
- Një pako e vogël me letra me ngjyra (si skeda)
- Lapsa/stilolapsa për të gjithë pjesëmarrësit
- Etiketa me emrat (shirit ngjitëseje i trashë, mbi të cilin mund të shkruhet)
- Lapsa të trashë për të shkruar emrat mbi etiketë
- Markues të trashë për Flipchart-in
- Shirit ngjitës, për të ngjitur fletët e bardha në mure
- Shirit ngjitës i tejdukshëm
- Gërshërë
- Guida dhe tabela për të dalluar sallat e mbledhjes dhe ato të punës („Këshilli i BE“, „Parlamenti Evropian“, „Komisioni“, Emrat e vendeve që aspirojnë anëtarësimin, „Mediat“), e krahas këtyre, në rast se nevojitet, edhe „Restorant“, „WC“, „Hyrja“, „Dalja“ etj.
- Broshurat me informacionet rreth BE në anglisht ose në gjuhën amtare (duhen tërhequr pranë të deleguarve të Komisionit të BE)

Dokumentat e Lojës-Plan

Dokumentat e Lojës-Plan duhet të përgatiten me shumë kujdes, në mënyrë që në momentin e ndarjes së roleve gjithçka të shkojë mirë me cdo kusht.

Nëse Loja-Plan për shembull është parashikuar për 40 pjesëmarrës dhe lajmërimi është bërë për këtë numër, duhet që të fotokopjohen edhe nja dy role të tjera rezervë, të cilat do të ishin për rastin nëse do të vinin më shumë pjesëmarrës.

Cdo pjesëmarrës merr këto dokumenta:

- Një përshkrim të shkurtër rreth kompetencave dhe institucioneve të BE
- Një përshkrim të shkurtër të vendeve (pjesëmarrëse) që aspirojnë anëtarësimin
- Një fletë me informacione nga vendi aspirant
- Skenari
- Informacione sekondare (Kriteret e kopenhagen-it)
- Rrjedhën e Lojës-Plan

Dokumenta shtesë për Komisionin:

- Cdo anëtar merr një përshkrim të Komisionit
- Kryetari i zgjedhur i Komisionit merr një tekst hyrjeje
Të dy dokumentat ngjiten paraprakisht me njëri-tjetrin.

Dokumenta shtesë për Këshillin:

- Hyrje e përgjithshme rreth Këshillit
- Përshkrim i rolit të Ministrit përkatës të Punëve të Jashtme
Të dy dokumentat ngjiten paraprakisht me njëri-tjetrin.

Dokumenta shtesë për Parlamentin e BE:

- Hyrje e përgjithshme rreth Parlamentit të BE
- Hyrje në Fraksionin, të cilit i përket deputeti
- Përshkrimi i rolit të deputetit
Të tre dokumentat ngjiten paraprakisht me njëri-tjetrin.

Dokumenta shtesë për secilin prej vendeve aspirante:

- Hyrje e përgjithshme rreth vendeve aspirante
- Përshkrim i rolit të vendit përkatës
- Formularë aplikimi
Të dy dokumentat e para ngjiten paraprakisht me njëri-tjetrin.

Dokumenta për anëtarët e grupit të mediave:

- Përshkrimi i rolit të mediave

6. Certifikatat e pjesëmarrjes

Vecanërisht tërheqës për pjesëmarrësit është fakti që në fund u dorëzohet si një kujtim, nxitje por deri në një farë mase edhe si shpërblim një certifikatë pjesëmarrjeje. Certifikatat duhet të jenë të përgatitura në mënyrë individuale, pra me emrin e pjesëmarrësit, datën dhe vendin e aktivitetit. Po kështu, shkurtimisht mund të paraqitet edhe përmbajtja e tij.

Certifikatat duhet të shtypen në një letër (të pastër) dhe të trashë, duhet të përmbajnë logo me ngjyrë – edhe ato të organizatave partnere – dhe duhet të jenë nënshkruar nga vetë drejtuesit e lojës resp. nga përfaqësues të organizatës partnere. Dorëzimi i

certifikatave mund të bëhet në kuadrin e një ceremonie festive. Këtu një mundësi do të ishte edhe luajtja e himneve të Bashkimit Evropian.

7. Raporti me miqtë dhe mediat e vërteta

Një Lojë-Plan është gjithmonë dicka interesante dhe zgjon shpesh një interes të vecantë – tek organizatat zbatuese, ato partnere por edhe tek shtypi. Nëse aktivitetet zhvillohen në shkolla apo universitete me nxënës apo studentë, në këto raste mund të tregojë interes edhe kuadri pedagogjik.

Duhet thënë qartë, që cdo i ardhur nga jashtë është një faktor shqetësues për simulimin, duke qenë se ky nuk është pjesë e të gjithë procesit. Nëse ardhja e të jashtme nuk mund të shmanget, atëherë duhet arritur që ata të sillen qetë, e të mos përzihen me komente, këshilla apo edhe me njohuri të gabuara. Në këto raste drejtuesit e lojës duhet të ndërhyjnë të vendosur dhe ndoshta të largojnë të ardhurin nga salla – e ndoshta – të flasë me ta në mbyllje të Lojës Plan. Edhe shtypi “I vërtetë” duhet t’u përmbahet rregullave dhe e shumta mund të intervistojë në pushimet e shkurtra aktorë të vecantë përpara dyerve të sallës. Këtu duhet bërë e qartë që pjesëmarrësit të intervistohen domodoshmërisht në rolet e tyre (si ministër, deputet apo komisioner). Nuk dëshirohet ndërprerja e nivelit të Lojës Plan. Në këtë mënyrë u duhet bërë e qartë edhe mësuesve të tjerë, që pa dyshim kanë qëllime të mira.

Nëse këta njerëz janë vazhdimisht të pranishëm gjatë aktivitetit, mund të shihet mundësia që edhe atyre t’u shpërndahen detyra dhe të përfshihen edhe ata (si shtyp, këshilltarë etj). Por për të gjithë pjesëmarrësit duhet të jetë e qartë, që nëse miqtë bëhen pjesë e Lojës-Plan ata nuk mund të dalin kur duan nga rolet e tyre ose të ndryshojnë identitetin. Për kuadrin pedagogjik ky opsion do të binte, pasi në Lojën Plan do të hynte në lojë vetvetiu dhe padashur hierarkia duke i vendosur lojtarët kështu në një situatë – minimumi të padëshiruar – vlerësimi nga ana e tyre.

Për këtë arsye instrumenti i përfshirjes së miqve duhet marrë në konsideratë me shumë kujdes.

8. Konceptimi i një deklaratë rinore drejtuar BE

Aktiviteti I Lojës-Plan mund të pasurohet me një element politik, me anë të të cilit pjesëmarrësve u jepet mundësia për t’ia komunikuar dëshirat dhe pritshmëritë e tyre Bashkimit Evropian. Forma e deklaratës së Përbashkët Rinore, të cilën organizatori në mbyllje do t’ua përcjellë politikanëve të vërtetë evropianë, ka treguar të jetë e suksesshme. Në këtë kontekst pyetja kryesore mund të ishte: Cfarë presim ne, pjesëmarrësit e Lojës-Plan, nga Bashkimi Evropian?

Si mënyrë të proceduari këtu do të përshtatej linja Parlamentit Evropian në ditën e dytë, ndërsa Këshilli është duke përfunduar bisedimet me shtetet që kanë aplikuar (shiko më sipër programin e ditës së dytë, ora 10:30). Parlamentarët marrin detyrën për të menduar një koncept, i cili lexohet më pas, përpara drekës, në plenum dhe komentohet si dhe nëse duhet, ndryshohet. Versioni përfundimtar lexohet edhe njëherë dhe miratohet në plenum me shumicë votash. Nëse në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjeve janë ftuar edhe miq të huaj, p.sh. Kryetari i Delegacionit të Komisionit Evropian, kjo deklaratë gjatë pushimit të drekës mund të përkthehet në një gjuhë të huaj, dhe pas deklaratës për shtyp të lexohet në publik. Miqtë ftohen të pozicionohen në

lidhje me këtë deklaratë. Qëllimi i këtij elementi është të mësojmë të shprehim dëshirat dhe pritshmëritë, të dimë ti formulojmë ato dhe të biem dakord rreth kësaj në një grup më të madh. Krahas kësaj, kjo ka edhe një efekt stimules mbi të rinjtë për të hyrë në kontakt me aktorët politikë, të cilët zakonisht ndodhen jashtë rrezes së tyre të veprimit.

Storybook

Fillimi i Lojës Plan

Loja jonë Plan fillon me një pritje në ambientet e **Komisionit Evropian** në Bruksel, në të cilën ndodhen **të gjithë aktorët**. Ky është një grup i vogël i përzgjedhur vendimmarrësish, që takojnë njëri tjetrin. Këta janë kryetarët e shteteve dhe të qeverive, parlamentarë të zgjedhur, anëtarë të Komisionit, të deleguar të shteteve aplikante dhe pak përfaqësues ekskluzivë të mediave, të cilët lidhin kontaktet e tyre të para dhe vendosin marrëdhënie në mënyrë të kujdesshme. Kryetari apo Kryetarja e Komisionit Evropian ka një rol udhërrëfyes dhe në mbyllje i jep shtypit një intervistë të hollësishme.

Takimi i parë

Institucionet e veçanta hynë menjëherë në salla më vete për një takim të parë pune. Ato nisin të konceptojnë pozicionet e tyre. Për këtë zhvillohet fillimisht një raund prezantimi gjatë të cilit përshkruhen shkurtimisht pozicionet politike të veçanta. Pas kësaj si Këshilli ashtu edhe Parlamenti Evropian zgjedhin nga radhët e tyre kryetarët përkatës si dhe vendosin për një rregullore të brendshme (p.sh.përcaktimi i kohës së fjalës, lista e folësve etj). Në mbyllje organet përkatëse nën drejtimin e kryetarit përpunojnë një statement („Çfarë na bashkon?“, „Çfarë na ndan?“, „Cilat janë interesat e përbashkëta të anëtarëve respektivë?“), dokument ky që do të përdoret si bazë për bisedimet e ardhshme.

Krahas kësaj të dy institucionet caktojnë një përfaqësues/e nga radhët e tyre, i cili / e cila do të kujdeset rregullisht për komunikimin reciprok mes aktorëve (ky person mund të quhet ndryshe edhe zëdhënës shtypi!).

Formulimi i kërkesave të aplikimit dhe dorëzimi i tyre

Aplikantët për anëtarësinë në Bashkimin Evropian formulojnë ndërkohë kërkesat e tyre për anëtarësim dhe ia dorëzojnë ato **Këshillit**. **Këshilli**, nga ana e tij, pranon kërkesat duke falënderuar aplikantët, dhe pa u thelluar në përmbajtjen e tyre, ua përcjell ato **Komisionit Evropian** dhe **Parlamentit Evropian**, me kërkesën që këta të pozicionohen në lidhje me to. Baza e këtyre pozicionimeve do të ishin diskutimet rreth kërkesave përkatëse të anëtarësimit me aplikantët. Por do të verifikohet vetëm, nëse aplikantët mund të garantojnë, që Kriteret e Kopenhagenit mund të plotësohen. Krahas kësaj vendet aplikante përpunojnë strategji dhe taktika për bisedimet e ardhshme me Këshillin, Komisionin Evropian dhe Parlamentin Evropian.

Prezantimet dhe diskutimet

Këshilli fton **vendet aplikante nga Evropa Qendrore dhe Juglindore**, që të prezantohen në një takim. Pasi Kryetari i këshillit bën një hyrje të shkurtër, secili prej përfaqësuesve referon shkurt rreth arsyeve pro anëtarësimit të vendit të tyre në BE. Pas kësaj vijojnë pyetje në lidhje me Kriteret e Kopenhagen-it. Dhe në mbyllje të bisedimeve Këshilli takohet me shtypin, ku duhet thënë që anëtarët e Këshillit veprojnë në mënyrë

diskrete lidhur me stadin aktual të arritjeve. Po kështu **Komisioni Evropian** dhe **Parlamenti Evropian** zhvillojnë biseda me aplikuesit rreth respektimit të Kriteve të Kopenhagen-it. Rezultatet e këtyre bisedimeve do të përfshihen në deklaratat e këtyre organeve.

Qëndrimet dhe vendimet

Këshilli paraqet këndvështrimin e vet të përbashkët me Komisionin Evropian dhe Parlamentin Evropian. Ai vendos nëse mund të nisin bisedimet e anëtarësimit dhe me cilat vende. Pas kësaj statusi i vendit kandidat njihet dhe jepet në mënyrë zyrtare.

Parlamenti Evropian nga ana e tij njofton në një seancë paralele pozicionin e vet, përkundrejt Këshillit. Në mbyllje përfaqësuesit e vendeve **kandidate** për anëtarësim shprehin në konferencë për shtyp dëshirat dhe pritshmëritë e tyre.

Fillimi i bisedimeve

Këshilli ngarkon menjëherë **Komisionin Evropian** me udhëheqjen e bisedimeve. Së bashku me të me **kandidatët për anëtarësim** (në një grup të madh me të gjithë kandidatët ose në grupe të veçanta pune sipas numrit të vendeve candidate) do të negociojë edhe **Këshilli** (në tërësinë e tij ose në grupim më të vogël të përzgjedhur) në lidhje me Marrëveshjen e Pranimit në BE. **Këshilli** diskuton rreth modaliteteve dhe kriteve të anëtarësimit si dhe përcakton programin kohor dhe rendin e bisedimeve.

Në mbyllje zhvillohet një *TALKshow* i shkurtër. Parlamenti Evropian njoftohet nga Komisioni në lidhje me vijimësinë e bisedimeve.

Votimi në Këshill dhe Parlamentin Evropian

Këshillit dhe **Parlamentit Evropian** u paraqiten Marrëveshjet, objekt i negociatave. **Këshilli** duhet të vendosë në mënyrë unanime mbi bazën e marrëveshjeve të arrira lidhur me pranimin e shteteve të tjera në BE. Parlamenti Evropian vendos me shumicë votash të anëtarëve të tij lidhur me pranimin e vendeve candidate në BE. Vendet candidate mund të jenë të ftuar të ndjekin procesin e votimit në Parlamentin Evropian.

Mediat dokumentojnë këtë proces votimi dhe në mbyllje marrin në intervistë anëtarët e Këshillit, deputetët si dhe përfaqësuesit e shteteve të reja; këto intervista publikohen më pas në gazetë.

Konferenca përmbyllëse

Në **Konferencën përmbyllëse** flasin përpara aktorëve në proces dhe gazetarëve fillimisht Kryetari i komisionit, dy anëtarë të Këshillit të Bashkimit Evropian, dy deputetët të Parlamentit Evropian dhe nga një përfaqësues i shteteve të reja anëtare. Marrëveshjet e anëtarësimit nënshkruhen. Kryetari i **Komisionit Evropian** dhe **Kryetari i Këshillit** marrin pjesë bashkarisht edhe në një *TALKshow* tjetër.

Propozime për ndarjen e roleve për madhësi të ndryshme grupesh

	25 Pjesëmarrës ¹	40 Pjesëmarrës	60 Pjesëmarrës	80 Pjesëmarrës ²
Këshilli Evropian	6 ³	12	20	27 ⁴
Komisioni Evropian⁵ (në tërësi)	2	3	3	5
Palamenti Evropian⁶ (në tërësi)	9 ⁷	13	21	23
EVP	3	4	6	7
SPE	2	3	5	6
Liberalët	2	2	4	4
Të Gjelbërit	1	2	3	3
E Majta Nordike	1	1	2	2
UEN	1	1	1	1
Shtetët aplikuese⁸	6 (3 vende me secili 2 Persona ⁹)	9 (3 vende me secili 3 Persona)	12 (4 vende me secili 3 Persona)	20 (5 vende me secili 4 Persona)
Mediat	2	3	4	5

Udhëzim për ndarjen e roleve: rekomandohet që Komisionin, Mediat dhe vendet aplikuese të zihen me nxënës që kanë një impakt të fortë e të angazhuar. Për këtë arsye, ndryshe nga realiteti, Këshilli do të zgjedhë edhe kryetarin. Parlamenti Evropian do të zgjedhë – njësoj si në realitet – kryetarin e vet, kjo gjithsesi sipas njohjeve politike dhe më pak atyre personale. Lojtarët duhet të stimulohen për të zhvilluar në mënyrë kuptimplote dhe politikisht realiste rolet e tyre.

¹ Me më pak se 25 lojtarë Loja Plan nuk ka më të njëjtin efekt. Në një situatë të tillë do të ishte e mundur të realizoheshin vetëm me rolin e Këshillit një simulim 2-3 orësh të një konference të Këshillit. Por kjo gjithsesi nuk do të ishte më një Lojë Plan në kuptimin e ngushtë të fjalës.

² Me më shumë se 80 lojtarë kapaciteti (kohor) i një Lojë Plan do të ishte shumë i lehtë për tu tejkaluar.

³ Në përzgjedhjen e lojtarëve duhet bërë kujdes, që mundësisht askush të „mos luajë vetvetën“. Lojtarët si anëtarë të Këshillit duhet që gjatë Lojës të marrin një kombësi tjetër nga ajo e tyre.

⁴ Në gjuhën gjermane ka role për të gjithë 27shtetet anëtare. 7 role për momentin nuk janë përkthyer ende. Natyrisht është e mundur, që shtetet më të mëdha (DE, FR, UK, IT, PL, SP ose RO) të kenë nga dy anëtarë.

⁵ Anëtarët e këtij grupi vendosin vetë, se kujt do t'i jepet roli i kryetarit / kryetares.

⁶ Raportet faktike të shumicës duhet që të ruhen të paktën në pamje të parë.

⁷ Një numër tek deputetësh bën të mundur, që institucioni të votojë dhe vendosë me shumicë të thjeshtë pa lënë kështu mundësinë e krijimit të një shtete Patt.

⁸ Drejtuesit e Lojës zgjedhin katër shtetet aplikuese me përgjegjësinë e tyre.

⁹ Në përzgjedhjen e lojtarëve duhet bërë kujdes, që mundësisht askush të „mos luajë vetvetën“. Lojtarët në rolin shteteve aplikuese duhet që gjatë Lojës të marrin një kombësi tjetër nga ajo e tyre.

Rrjedha e Lojës-Plan mbi BE „Evropa në një formë të re“

Dita 1

Ora	Përshkrimi i aktivitetit		
09:30	Mbërritja dhe regjistrimi i pjesëmarrësve ë hyrje		
10:00	Plenum: Përshëndetja, prezantimi i drejtuesve të lojës, njohja me informacionet e përgjithshme rreth organizimit (Fillimi dhe fundi i aktivitetit ditën e parë dhe të dytë)		
10:30 – 10:45	Plenum: Prezantimi i programit të të dy ditëve (moderacion i përgjithshëm), nëse është e mundur duke e vizualizuar (PowerPoint ose Flipchart)		
10:45 – 11:45	Plenum: Ndarja e lojtarëve në grupe pune (diku te 10-15 persona) në lidhje me informacionet hyrëse rreth BE Grupet shpërndahen në dhoma të veçanta të punës		
11:45 – 12:00	Pushim dhe pihet diçka		
12:00	Plenum: Prezantimi i rrjedhës së Lojës-Plan (Moderacion i përgjithshëm) Shpërndarja e roleve Grupet shkojnë në dhomat e tyre të punës, lexojnë përshkrimet e roleve, mendojnë për emra fiktivë e të përshtatshëm dhe përgatisin etiketat me emrin e tyre Anëtarët e Komisionit zgjedhin një person si President, i cili përgatit edhe një fjalë hapëse		
13:00	Plenum: Moderacion i përgjithshëm, shpjegohen parimet e Lojës-Plan dhe hapet ajo zyrtarisht		
13:15	Plenum: Fjala e Presidentit të Komisionit, pas kësaj të gjithë të pranishmi ftohen në një drekë përshëndetëse zyrtare në emër të Komisionit Evropian		
13:30 – 14:30	Dreka		
14:30 – 15:00	Vendet që synojnë anëtarësimin (Aplikantët): përgatiten shkresat e aplikimit, prezantime për bisedimet në organizmat e BE	Parlamenti (EP): Deputetet e EP prezantojnë veten dhe pozicionet e tyre, pastaj zgjidhet Presidenti, zëvendësi dhe zëdhënësi; Gjetja e pozicioneve të përbashkëta / përgatitja e një deklaratë për shtypin	Këshilli: Anëtarët e Këshillit prezantojnë veten dhe pozicionet e tyre, pastaj zgjidhet Presidenti, zëvendësi dhe zëdhënësi; Gjetja e pozicioneve të përbashkëta / përgatitja e një deklaratë për shtypin
15:00 – 15:30	Aplikantët: i dorëzojnë kërkesat Këshillit	Këshilli: Përcjell kopje të kërkesave në EP/EK me lutjen për pozicionime dhe zhvillim bisedimesh	Komisioni (EK): Përmbledh pozicionet nga fjalimet, përgatit një deklaratë për shtyp dhe zhvillon një koknferencë të parë për shtyp
			Mediat: Kërkesat e vendeve aplikante, deklarata për shtyp e EK dhe intervistat (raportet) prezantohen në një stendë shtypi quajtur ndryshe gazetë muri

Ora	Përshkrimi i aktivitetit			
15:30 – 16:45	Aplikantët zhvillojnë bisedime për rreth 15 minuta me Këshillin , EP dhe EK , shoqërohen dhe intervistohen. Mediat informojnë më pas opinionin publik. Rrjedha kohore e bisedimeve realizohet sipas një matrice të parapërgatitur, e cila u është shpërndarë të gjithëve (shih matricën).			
16:45 – 17:00	Pushim			
17:00 – 17:30	EP: këshillon në lidhje me aplikimin dhe bisedon me aplikantët rreth dhënies së statusit të kandidatit	Këshilli: këshillon në lidhje me aplikimin dhe bisedon me aplikantët rreth dhënies së statusit të kandidatit	EK: këshillon në lidhje me aplikimin dhe bisedon me aplikantët rreth dhënies së statusit të kandidatit	Mediat: marrin përshtypjet e aplikantëve në lidhje me atmosferën dhe pritshmëritë e aplikantëve dhe zhvillojnë intervista
17:30 – 18:00	EP: harton pozicionet e tij në lidhje me aplikimet dhe ia përcjell këto Këshillit	EK: harton pozicionet e tij në lidhje me aplikimet dhe ia përcjell këto Këshillit	Këshilli: pranon pozicionet, diskuton pozicionet e veta. Përgatit pyetje eventuale drejtuar EK dhe EP	
18:00 – 18:15	Plenum: Moderatori bën një përmbledhje të ditës dhe sqaron ditën vijuese			

Dita 2

Ora	Përshkrimi i aktivitetit			
9:00	Mbërritja e pjesëmarrësve dhe drejtuesve të lojës			
9:15	Plenum: Përshëndetje nga moderatori i përgjithshëm, i cili jep shpjegimet e duhura në lidhje me rrjedhën e mëtejshme të ditës / Lojës-Plan			
9:30 – 10:00	Këshilli merr vendim unanim në lidhje me ata aplikantë, që do të marrin statusin e vendit kandidat	EK dhe EP: EK shkon në EP dhe informohet lidhur me pozicionimin e EP dhe diskuton rreth shanseve të aplikuesve të veçantë për tu bërë kandidatë	Aplikantët: zhvillojnë bisedime me mediat / bëjnë lobbying për vendin e tyre	Mediat: intervistojnë aplikantët (Greenroom)
10:00 – 10:15	Plenum: Koponferencë për shtyp – Këshilli jep vendimin e vet, se cilët prej aplikantëve do të bëhen kandidatë, dhe e argumenton atë. Aplikantët, që nuk e kanë marrë statusin e kandidatit, bejnë punë me publikun së bashku me grupin e mediave.			
10:15 – 10:30	Pushim			

Ora	Përshkrimi i aktivitetit	
duke nisur nga 10:30	Bisedime, cilët kandidatë (kush!) në cilin moment (kur!) dhe me cilat kushte (si!) do të pranohet në BE si anëtar i tij.	
10:30 – 11:30	<p>Këshilli: ndahet në grupet e negociimit dhe zhvillon bisedime në praninë e një anëtari të EK me një vend kandidat për anëtarësim (nga vende aplikante janë bërë kandidatë për anëtarësim) rreth përmbajtjeve të marrëveshjes</p>	<p>Varianti 1 (varianti I thjeshtë): EP dhe Mediat marrin pjesë në nënshkrimin e Marrëveshjeve si vëzhgues.</p> <p>Varianti 2 (varianti kreativ): EP dhe Mediat organizojnë një prezantim të shkurtër përmbyllës (interaktiv), në lidhje me arsyet përse shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet të jenë një pjesë e rëndësishme e BE.</p> <p>Varianti 3 (formimi klasik politik – më ambiciozi): EP dhe Mediat diskutojnë, se si mund të ushtrohet një ndikim më i madh mbi vendimet e politikës (ne vendin tuaj dhe në BE) dhe përse është kaq i rëndësishëm ky ndikim.</p>
11:30 – 12:00	<p>EK dhe EP: Anëtarët e EK shkojnë në Parlament, raportojnë në lidhje me zhvillimin e bisedimeve dhe pas përfundimit të tyre i paraqesin Parlamentit marrëveshjet përkatëse, i cili merr një vendim në lidhje me këto <u>me shumicë të thjeshtë</u></p>	<p>Këshilli: vendos në mënyrë <u>unanime</u> në lidhje me rezultatet e bisedimeve resp. marrëveshjet.</p>
12:00 – 13:30	Drekë dhe heshtje e detyruar ☺ rreth rezultateve të votimit	
13:30	<p>Plenum: Nënshkrim ceremonial i Marrëveshjeve nga vendi kandidat (tanimë anëtar i BE), EK dhe Këshilli në prezencë të shtypit, deklarate e vendeve të reja candidate të BE (dikur aplikantë dhe kandidatë) dhe në mbyllje njëkonferencë për shtyp</p>	
14:00	Fundi i Lojës-Plan	
14:00 – 14:30	Pushim, pihet diçka	
14:30 – 15:30	Vlerësimi i Lojës-Plan dhe rezultatet (krahasimi me realitetin) si dhe shpërndarja e certifikatave të pjesëmarrjes	
15:30 – 15:45	Ndarja dhe mbyllja e aktivitetit	

	Aplikanti I.	Aplikanti II.	Aplikanti III.	Aplikanti IV.
Këshilli	1	2	3	4
Parlamenti Evropian	2	3	4	1
Komisioni Evropian	3	4	1	2

Shembull shpërndarjeje në parim

	Aplikanti I.	Aplikanti II.	Aplikanti III.	Aplikanti IV.
Këshilli	15:00	15:15	15:30	15:45
Parlamenti Evropian	15:15	15:30	15:45	15:00
Komisioni Evropian	15:30	15:45	15:00	15:15

Shembull për organizimin kohor

Rregulla për punën e drejtuesve të Lojës Plan

1. Duhet të krijohet një **drejtori e përgjithshme pa një grup loje të vetin**, e cila do të shpjegojë parapara fillimit të lojës së vërtetë rrjedhën e të gjithë lojës, gjë që e vazhdon edhe brenda lojës. Pra ajo flet për institucionet evropiane Këshillin, Parlamentin dhe Komisionin, emëron funksionet dhe detyrat, u drejtohet pjesëmarrësve me „Ju“ apo me titullin korrekt (p.sh zoti Kryetar, Zonja Ministre e Jashme etj). Kjo drejtori e përgjithshme duhet të caktohet paraprakisht, në mënyrë që të ketë mundësi të përgatitet. E rëndësishme është të bëhet kujdes, që pjesëmarrësit të mos dalin nga ky nivel edhe gjatë Lojës Plan. Përpara Lojës Plan e gjithë Drejtoria e Përgjithshme diskuton edhe njëherë më të gjithë pjesëmarrësit rrjedhën e lojës dhe tërheq vëmendjen në lidhje me vecoritë apo ambientet, grupet, praninë e miqve etj. Gjatë Lojës-Plan Drejtoria e Përgjithshme i drejton pjesëmarrësit përgjatë gjithë Lojës.
2. **Rrjedha e Lojës** duhet të vizualizohet që përpara fillimit të Lojës (ose të skicohet) në një tabelë apo Flipchart (për cdo ambient ku zhvillohet Loja), të vihet në këtë mënyrë në dispozicion të pjesëmarrësve, edhe në formën e një formati A4.
3. Udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme rreth **rrjedhës së mëtejshme të Lojës** në takimet plenare (p.sh. në konferencat e shtypit). Në të njëjtën mënyrë sikurse u shpjegua edhe në pikën 1 Drejtoria e Përgjithshme shpjegon se si do të vijojë loja më tej. Kjo është e rëndësishme para së gjithash, nëse rrjedha e lojës do të duhet të ndryshojë disi në mënyrë spontane (p.sh. për shkak të mbledhjeve shtesë të Këshillit, pasi në kohën e vënë në dispozicion nuk është mundur të bihet ende dakord). Kjo ka të bëjë para së gjithash me njoftimin e orareve të sakta (apo ndryshimeve të tyre).
4. **Roli i Drejtuesve të Lojës në grup loje më vete.** Drejtuesit e lojës duhet që të identifikohen me një emër të tyre në lojë p.sh. këshilltarë politikë të Kryesisë së Këshillit. Nëse nevojitet ndërhyrja e tyre në grupin e lojës atëherë kjo duhet bërë gjithmonë me këtë identitet dhe Brenda rregullave të Lojës, pra duke u drejtuar me “Ju” dhe me emrin e lojës apo funksionin përkatës p.sh. Zonja Kancelare Federale, zoti Ministër i Jashtëm etj ... Drejtuesi i Lojës tregon kujdes që kjo të bëhet edhe mes vetë lojtarëve.
5. Nëse drejtuesi i lojës duhet të ndërhyjë në ngjarjen e Lojës, kjo duhet që mundësisht të bëhet vetëm me argumenta politikë resp. strategjikë, pra Brenda Lojës duhen dhënë stimuj me argumenta. Shembull: „në rast problemesh vendimmarrjeje duhet dhënë udhëzimi në lidhje me mundësinë, që shtetet, që kërkojnë anëtarësimin, mund të ftohen për një bisedë të mëtejshme, me qëllim që të merren informacione të tjera“ ose të sillen në vëmendje alternativa si „A është korrekte politikisht të mos e pranojmë këtë vend?“.

Menaxhimi i pushimeve gjatë Lojës Plan

Pushimet në një Lojë Plan janë një element i rëndësishëm dhe bëjnë pjesë në mënyrë të vetëdijshme në rrjedhën e saj. Pushimet nuk shërbejnë vetëm për shpłodhjen e pjesëmarrësve nga puna e „kryer“, për më tepër ato duhet të ofrojnë hapësirë për biseda mes njëri-tjetrit në grupet e lojës, për të lidhur dhe farkëtuar aleanca në raunde jozyrtare bisedash dhe për të informuar shtypin në lidhje me veprimet e mëtejshme si dhe për ti „instrumentalizuar“ ato në mënyrë pozitive në funksion të objektivave të tua.

Pjesëmarrësve u duhet bërë e qartë, që rruga drejt vendimmarrjes pozitive mund të përgatitet në nivele të ndryshme. Shpesh për këtë qëllim bisedat kokë më kokë dhe në mirëbesim janë një element shumë i rëndësishëm, për të informuar vendimmarësit dhe për ti ndikuar ata. Kjo mënyrë të vepruari në më të shumtën e rasteve është e mundur vetëm gjatë pushimeve.

Për EP, Mediat (nëse nuk janë të ftuara në bisedimet për anëtarësim) dhe shtetet aplikuese të papranuara një pushim i madh do të ishte faza e bisedimeve mesh Këshillit, Komisionit dhe shteteve kandidate të lejuara rreth anëtarësimit eventual në BE. Këtu ka variante të ndryshme se si mund të shfrytëzohet koha:

Varianti 1 (Varianti i thjeshtë):

EP, Kandidatët e papranuar dhe Mediat marrin pjesë në nënshkrimin e Marrëveshjeve si vëzhgues. Kjo fillimisht mund të jetë monotone dhe e mërzitshme, por për të kuptuar procesin sa i përket vështirësive të zgjerimit pjesëmarrja do të ishte vecanërisht e vlefshme.

Varianti 2 (Varianti kreativ):

EP, Kandidatët e papranuar dhe Mediat organizojnë një prezantim të shkurtër përmbyllës (interaktiv), në lidhje me arsyet përse shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet të jenë një pjesë e rëndësishme e BE. Janë të lejuara të gjitha format kreative të një prezantimi.

Varianti 3 (formimi klasik politik – më ambiciozi):

EP, Kandidatët e papranuar dhe Mediat diskutojnë, se si mund të ushtrohet një ndikim më i madh mbi vendimet e politikës (ne vendin tuaj dhe në BE) dhe përse është kaq i rëndësishëm ky ndikim. Në këtë pikë lëvizet në periferi të Lojës Plan për të shkuar drejt diskutimit më të rëndësishëm. Edhe në këtë rast pjesëmarrësit duhet të qëndrojnë brenda roleve të tyre.

Mediat – një rol mundësish?

Një Lojë-Plan është modeli i një sistemi kompleks. Lojërat-Plan në formimin politik (Civic Education) janë simulimi i një fragmenti prej botës së parrokshme politiko-institucionale¹. Në këtë botë bëjnë pjesë aktorët politikë në organizmat e tyre, shoqëria e qytetarëve dhe qytetareve si pikënisje dhe pikëmbërritje e veprimit politik dhe mediat si ndërmjetës mes politikës dhe shoqërisë. Për këtë arsye mediat janë edhe baza edhe përmbajtja e formimit politik². Ky material nuk analizon pajimin më të mirë teknik të grupit mediatik, por se si mund të shfrytëzohen më mire ato në kuadër të Lojës-Plan.

Mediat – ndërmjetës mes politikës dhe shoqërisë

Ai që dëshiron të informohet në politikë ka nevojë për lajmet. Mes dërguesit dhe marrësit të lajmit qëndrojnë mediat. Fjala latine „medium“ nuk do të thotë asgjë tjetër vecse „mes“. Të gjithë proceset audiovizuale në përcjelljen e informacioneve, pamjeve, lajmeve, quhen media. Këtu bëjnë pjesë mediat e reja si për shembull interneti, radio, televizioni dhe ato që ndryshe quhen mediat e shtypura, më saktë gazetatat dhe revistat. Fjalët Media dhe Shtyp shpesh përdoren për të shprehur të njëjtën gjë³.

Në sistemet demokratike mediat janë pushteti i katërt. Ato janë të pavarura nga ndarja shtetërore e pushteteve mes Legjislativit (ligjvënies përmes parlamenteve), ekzekutivit (realizimi përmes qeverive) dhe gjyqësorit (jurisdiksioni përmes gjykatave). Vetë mediat zotërojnë pushtet politik, duke mbështetur apo penguar vendimmarrje të caktuara. Për këtë arsye ato janë shumë më tepër se një „mes“ midis dërguesit dhe marrësit të një lajmi.

Opinion publik shesh cilësohet si „opinion i publikuar“. Mediat kanë pushtet për shkak të publikimit. Politikanët dhe politikanet e shfrytëzojnë këtë pushtet për shembull kur inskenojnë fushatën mediatike. Vecanërisht në sisteme diktatorale përfaqësues të mendimit të opozitës kërkojnë publikimin nëpërmjet mediave: Vetëm atij që ia vënë veshin, mund të thotë dicka. Për këtë arsye, ata që sundojnë kërkojnë të pengojnë shtypin e lirë. Pra pushteti I mediave është i kërcënuar dhe për këtë arsye duhet mbrojtur. Liria e shtypit është një ndër liritë më të vjetra në sistemet demokratike. Të gjitha kushtetutat e shteteve ligjore demokratike përmbajnë një nen, që garanton lirinë e shtypit. Në Gjermani ky është neni 5 i Kushtetutës, ndërsa Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore e formulon kështu nenin 11: „Liria e mediave dhe pluralizmi I tyre duhet të respektohen“. „E vërteta“ është pra për mediat një vetëobligim, por askush nuk mund t'i detyrojë ato.

Po kështu edhe në një fushë tjetër mediat dominojnë të përditshmen. Për shumë njerëz gazetatat e mëngjesit dhe edicionet kryesore të lajmeve në mbrëmje përbëjnë një ritëm ditor fiks. Lajmet janë të rëndësishme për njerëzit pavarësisht nga përmbajtja e tyre. E që

¹ Si hyrje në shembull: Massing, Peter 2006, Lojërat Plan dhe Lojërat e Vendimmarrjes, në: Zyrën Qendrore për formim politik (bot.), Trajnim metodik për mësime të politiksë I, Botimi i dytë, Bonn, faqe. 163-194.

² Mickel, Wolfgang W. 2003, Praktikë dhe metodë. Hyrje në teorinë metodike të formimit politik, Berlin: Shtëpia botuese Cornelsen, faqe. 278ff.

³ krahaso enciklopedi të fushës si: Schubert, Klaus / Klein, Martina 2006, Enciklopedi e politikës, Bonn: Zyra Qendrore për Formimin Politik.

prej shpikjes së shtypshkronjave nga Johannes Gutenberg⁴ në fillim të shek. XV medat janë shndërruar edhe në memorizues dijesh. Gazetat e vjetra të informojnë në lidhje me kohë të shkuara.

Mediat në realitet janë:

- Instrumenta njoftimi dhe informimi (mes politikës dhe shoqërisë),
- Mjete fushate (pra mjete të pushteti politik),
- Instrument ritmi (mes gazetës së mëngjesit dhe lajmeve të mbrëmjes),
- Instrument dokumentimi (arkiv idesh).

Mediat në Lojën-Plan

Lojërat-Plan janë instrumenta të të mësuarit orientuar për nga veprimi. Të veprash do të thotë të bësh dhe të reflektosh rreth asaj, që bën. Të veprash, në formimin politik do të thotë të veprash realisht, të veprash duke simuluar dhe të krijosh në mënyrë produktive. Të vepruarit real nuk gjendet në Lojën-Plan. Rolet e mdiave janë si simulime ashtu edhe krijime produktive.

Rëndësia e mediave për realitetin shoqëror në sistemet demokratike nuk njhet shumë prej pjesës më të madhe të të rinjve. Mediat në vetvete janë një mjet informacioni. Liria dhe pushteti politik i mediave njihen pak. Lojërat Plan sic është „Evropa në një formë të re” mund të ndihmojnë për të kuptuar më mirë mediat. Në fazën përgatitore të Lojës Plan, shumë-shumë gjatë ndarjes së roleve, drejtuesit e lojës duhet të japin udhëzimet përkatëse për të gjithë lojtarët dhe lojtaret në lidhje me funksionet e ndryshme të mediave. Në këtë hyrje rreth funksioneve të mediave bën pjesë informacioni rreth pavarësisë së mediave. Ju jeni aktorë të pavarur dhe autonomë dhe do Ju duhet domosdoshmërisht të bashkëpunoni me ata, rreth të cilëve do të informoni. Politikanët dhe politikanet kanë një përvojë autonomie të tillë, e cila tregon që mediat raportojnë atë që duan. Ndaj edhe Ju bashkëpunoni me mediat për të arritur opinionin publik.

Mediat mund të ndihmojnë për t'i dhënë Lojës-Plan një strukturë më të qartë. Në mënyrë të ngjashme me vështrimin ritual në gazeta dhe në edicionet e lajmeve, për Mediat në Lojën-Plan mund të caktohet gjithashtu një kohë e caktuar. Edhe në një Lojë-Plan të shkurtër shpesh mbyllja e përbashkët do të ishte një konferencë shtypi apo një talk-show. Talkshows apo regjistrime video në formën e një edicioni kryesor lajmesh janë normalisht më të përshtatshme se sa konferencat e shtypit, duke qenë se ato bashkojnë në një podium një grup mediash dhe disa partnerë interviste si dhe i vënë ata bashkë me lojtarët e tjerë në rolin e publikut.

Madje në fillim të një Loje-Plan, pas fazës hyrëse, një talkshow mund të përmbushë një detyrë të vecantë. Shpesh pjesëmarrësit dhe pjesëmarrëset e një talkshow e ndjejnë vetën të pafuqishëm përkundrejt situatës fillestare, kjo është dicka që përsëritet herë pas here në raundet e vlerësimit përfundimtar. Atyre u duhet që brenda një kohe të shkurtër të pranojnë një sasi tejet të madhe e kësaj të parrokshme informacioni si dhe të përgatisin rolet e tyre. Në më të shumtën e rasteve stresi I fillimit kalohet shpejt nëse fillohet me lojën e vërtetë të roleve. Ky moment “magjik” i gjetjes së identitetit në një rol

⁴ Giesecke, Michael 1998, Shtypja e libit në fillim të kohëve moderne. Një rast studimor historik mbi aplikimin e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit, Frankfurt/M.

të caktuar mund të mbështetet nëse grupit të mediave i ofrohet mundësia për të intervistuar pjesëtarë të vecantë përpara publikut në formën e një talkshow. Mediat janë në këtë rast një katalizator rolesh. Lojtarët dhe lojtaret duhet të futen në rolet e tyre gjatë intervistave duke u sjellë kështu shpesh në mënyrë cuditërisht mjaft bindëse.

Natyrisht edhe në Lojërat Plan mediat janë në rol informues. Por për këtë pjesëmarrësve dhe pjesëmarrëseve u duhet bërë paraprakisht e qartë, që ata mund t'i përdorin mediat për të informuar lojtarët apo lojtaret e tjera dhe organizmat e ndryshme. Këtë detyrë qendrore mediat zakonisht mund ta përmbushin vetëm nëse kanë mjaftueshëm kohë në dispozicion. Në Lojëra Plan të shkurtra njëditore anashkalohet shpejt nevoja aktuale dhe afatshkurtër e informimit të individit. Lojtarë dhe lojtare të ushtruara e njohin këtë mungesë kohe dhe zakonisht dinë ta menaxhojnë mirë duke dhënë lajme tejet të shkurtuara dhe esenciale përmes mediave. Kjo vlen si për rolet e mediave ashtu edhe për të tjerat. Një efekt i rëndësishëm dhe i mundshëm i të mësuarit! Edhe në realitet në media vinë vetëm politikanë dhe politikane, që mund të përcjellin në mënyrë të shkurtër e të përmbledhur mesazhet e tyre. Një fazë më e gjatë reflektimi mund të vërë përballë njëri-tjetrit efektin e fjalës kyce me një punë të mirë kërkimore mediatike si dhe të kërkojë arsye dhe rrugëdalje.

Në Lojërat-Plan edhe drejtuesit e lojës mund të përdorin grupin e mediave si kanal informacioni. Për shembull për të sjellë një udhëzim apo një stimul loje gjatë rrjedhës së saj. Udhëzimet e regjisë janë të vështira në një Lojë Plan, pasi ato nuk janë në skenën e lojës por luhen në një nivel „meta“. Nëse drejtuesit e lojës kërkojnë të respektohet një plan i caktuar kohor, këta, duke shfrytëzuar mediat, mund të paralajmërojnë për shembull për një grevë që pritet të bëhet në aeroport, në mënyrë që organizmat e ndryshme të mund të marrin një vendim brenda 30 minutave, pasi përndryshe nuk do të kenë mundësi të nisen në udhëtim. Presioni i kohës është një faktor i rëndësishëm edhe në realitet, kur duam të kapërcejmë situata ngërci.

Tek „Evropa në një formë të re“ janë vecanërisht rolet opozitare në parlament dhe vendet candidate për anëtarësim, por që nuk janë ftuar në bisedime anëtarësimi, ato që mund të shfrytëzojnë mediat që gjithsesi të mund të arrijnë opinionin publik. Në realitet këto grupe faktikisht nuk kënaqen me mungesën e aktivizimit dhe monotoninë, e ndonjëherë, përmes fushatave mediatike, kërkojnë të krijojnë një atmosferë të caktuar për një problem të tyrin. Kjo është e mundur edhe në Lojën Plan dhe kjo gjë i mbron vërtetë disa role nga një masë e tepruar dhe jo e shëndetshme monotonie dhe mërzie. Në fazën e reflektimit vlerësohet vecanërisht funksioni dokumentues i mediave. Gazetat e murit dhe artikujt e ndryshëm mund të shfrytëzohen për të tematizuar edhe njëherë faza të vecanta të lojës dhe për të diskutuar rreth këndvështrimeve të ndryshme. Materialet e përgatitura në mënyrë produktive mund të prezantohen mjaft mirë edhe në shtypin e vërtetë.

Mediat janë në Lojën Plan:

- Përvoja autonomie (Mediat mund të informojnë, por nuk duhet domosdoshmërisht),
- Instrumente strukturore (aksione shtypi të përcaktuara në kohë),
- Katalizator rolesh (Formim i identitetit përmes vetëprezantimit),
- Instrumente raportuese (mes roleve dhe institucioneve),
- Mjete stimuluese (ndërpresin situatat e ngërcit),

- Instrumente fushate (mes roleve dhe institucioneve),
- Instrumente dokumentimi (Vizualizimi)⁵.

⁵ Herdegen, Peter 2007, „Loja Plan“ në: Lange, Dirk (bot.), Metodat e formimit politik, Baltmannsweiler: Shtëpia botuese Schneider Hohengehren, faqe. 180-188.

WARM UPS

Zinxhiri i impulseve

Qëllimi: Ushtrim ngrohjeje në fillim të një seminari

Rrjedha: Grupi formon një rreth dhe kapet pas dore. Drejtuesi i lojës jep një impuls, i cili përcillet nga njëri tek tjetri në drejtim të akrepave të orës fillimisht mund të realizohet një shembull i thjeshtë: drejtuesi i lojës shtyp me dorën e vet të majtë dorën e fqinjit/es, i cili /e cila nga ana e vet do ta përcjellë këtë tek tjetri sa më shpejt të jetë e mundur. Me një kronometër / orë matet koha deri në mbyllje të ciklit. Kalimi i impulsit përsëritet duke u mundur që koha të jetë më e shkurtër.

Variante: Impulset mund të variojnë p.sh:

- ngremë duart lart dhe e përcjellim impulsin duke trokitur dorën e tjetrit
- ngritja e duarve në formën e valës Ola

Koha: 5 – 10 minuta

Grupi i synuar: mosha jo specifike, duke nisur nga 15 persona

Vendi: klasë ose në ambient të hapur

Materiali: Orë me tregues sekondash ose kronometër

Lejleku dhe pinguini

Qëllimi: Ushtrim çtensionimi, i përshtatshëm vecanërisht për ambient të hapur

Rrjedha: Pjesëmarrësit lëvizin si pinguinë, pa ngritur këmbët dhe duke i mbajtur krahët anash. Vetëm një nga pjesëmarrësit është lejleku. Ai i mban krahët të shtrirë drejt përpara kraharorit dhe i hap e mbyll ato për të imituar lëvizjen e sqepit të lejlekut. Me këmbë imiton ecjen e lejlekut; dhe duke lëvizur në këtë mënyrë lejleku përpiqet të zërë pinguinë. Sapo kap një të tillë, ky shndërrohet menjëherë në lejlek, dhe vazhdohet kështu derisa në fund të gjithë pjesëmarrësit janë shndërruar në lejlekë.

Koha: 10 minuta

Grupi i synuar: mosha jo specifike, duke nisur nga 15 persona, i përshtatshëm vecanërisht për grupe të mëdha

Vendi: klasë e madhe, optimale do të ishte në ambient të hapur

Materiali: nuk ka nevojë

Toaster

Qëllimi: Ushtrim ngrohjeje në fillim të një seminari

Rrjedha: Pjesëmarrësit ndahen në grupe treshe dhe shpërndahen në klasë. Pjesëmarrësit e skuadrës shpjegojnë figurat e përshkruara më poshtë. Njëri prej tyre qëndron në mes, i drejtohet njërit nga grupet treshe të rrethit dhe thërret njërin nga figurat e poshtëpërmendura.

Ky grup duhet të formojë shpejt figurën e thirrur. Kush është shumë i ngadaltë duhet të shkojë në rreth e kështu me rradhë. Mund të formohen figurat e mëposhtme:

Elefanti: Pjesëmarrësi/sja të cilës i drejtohem, formon pjesën qendrore të figurës, kap shpejt hundën me dorë dhe harkut, që formon krahu. i ngjitet dora tjetër në formën e nockës së elefantit. Ndërkohë pjesëmarrësit majtas dhe djathtas formojnë me krahun e djathtë përkatësisht të majtë veshët e elefantit.

James Bond: Figura qendrore zgjat krahun përpara sikur është duke gjuajtur me armë dhe vështron në mënyrë joshëse, ndërsa pjesëmarrësit në të majtë dhe të djathtë ulen në gjunjë dhe shohin drejt Bond dhe thonë: „Oh James“.

Toaster: Lojëtarët djathas dhe majtas rrotullohen anash në mënyrë që të shohin dhe prekin njëri-tjetrin në të dyja duart. Figura qendrore në këtë rast është feta e bukës toast, e cila kërcen nga e çara e toaster-it dhe thërret: „Pling!“.

Lavatrice: Pjesëtarët majtas e djathtas bashkojnë duart dhe formojnë një rreth. Personi në mës rrotullon kokën si të jetë duke centrifuguar.

Koha: 10 minuta

Grupi i synuar: mosha nuk është specifike, e përshtatshme edhe për grupe të mëdha.

Vendi: dhomë e madhe për grupet ose në natyrë

Materiali: nuk janë të nevojshme

Bllok akulli

Qëllimi: Ushtrim në bashkëpunim me karakter grupformues

Rrjedha: Në një dhomë bosh vihen dy tavolina bashkë. Këto përfaqësojnë bllokun shpëtues të akullit. Tani secili prej pjesëmarrësve merr një karrige e vendos diku në dhomë, dhe hip mbi të. Dyshemeja është uji. Qëllimi është të arrijnë në ishullin e akullit jo vetëm, por të gjithë së bashku si grup, pa lënë ndonjë mbi një copë të vogël akulli (karrigë) apo në ujë (kur nuk mjafton një karrige). Pjesëmarrësit arrijnë kështu duke lëvizur mbi karrige deri tek blloku i akullit, dhe gjatë kësaj mund të shtyjnë edhe karriget e tjera. Në të gjithë këtë lojë ata duhet të mendojnë mjaft mirë si grup një rrugë të caktuar, se kush duhet të shkojë prej nga i pari në ishull, kush duhet ta ndjekë etj.

Koha: 15 minuta

Grupi i synuar: duke nisur nga 12 vjeç, me jo më pak se 10 persona

Vendi: klasë e mjaftueshme për grupe

Materiale: Karrige aq sa pjesëmarrës, dy tavolina

Kufinjtë e Evropës

Qëllimi: Hyrje në temë, përballje me temën Evropa

Rrjedha: Pjesëmarrësve u shpërndahet një hartë Evrope. Ata duhet të rrethojnë me laps shtetet që sipas mendimit të tyre do të jenë pjesë e Bashkimit Evropian në vitin 2020. Pas kësaj pjesëmarrësit krahasojnë kufijtë e tyre, japin shpjegime në lidhje me to dhe diskutojnë rreth politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian.

Nëse grupi është relativisht i madh kjo mund të bëhet edhe me grupe të vogla.

Koha: 30 – 45 minuta

Grupi i synuar: duke nisur nga mosha 15 vjeç, 10-20 persona

Vendi: Rreth karrigesh në një klasë për grup të madh

Materiale: Harta të Evropës

Metoda të vlerësimit

Topi rrufe

Qëllimi: Vlerësim i pakomentuar

Rrjedha: Pjesëmarrësish ulen në karrige në formë rrethi. Drejtuesi i skuadrës i hedh topin njërit prej pjesëmarrësve, që kapet në befasi si të ishte rrufë. Ky mund të japë vetëm një vlerësim të shkurtër dhe të pakomentuar në lidhje me seminarit/workshop-in, por nuk

duhet të thotë gjë në lidhje me këtë. Kur të ketë mbaruar i hedh topin një pjesëmarrësi tjetër, dhe vetëm ai që kap topin ka të drejtën e fjalës. Thëniet mbeten pa koment

Grupi i synuar: Mosha e paspecifikuar

Materiale: top i vogël

Semafor letre

Qëllimi: Vlerësim individual dhe në grup

Rrjedha: Pjesëmarrësit rrinë ulur në karrige vendosur në formë rrethi, se cili prej tyre merr një kartë të kuqe, të gjelbër dhe të verdhë, ku e kuqja do të thotë vlerësim negativ, e gjelbërta vlerësim pozitiv, e verdha as mirë as keq.

Drejtuesi bën pyetje të ndryshme në lidhje me vlerësimin e seminarit/workshop-it, si p.sh.: Si ju është dukur metoda? A ju është dukur interesante tema? Mendoni se keni mësuar më tepër?

Pas kësaj pjesëmarrësit vendosin para tyre, mbi dysheme, kartën e tyre të vlerësimit dhe mësojnë edhe rreth vlerësimit të të tjerëve. Drejtuesi/sja bën një përmbledhje të vlerësimeve dhe mund t'u drejtoje pyetje pjesëmarrësve të veçantë, duke u dhënë atyre mundësinë e argumentimit.

Koha: 10 – 20 minuta

Grupi i synuar: duke nisur nga 12 vjeç

Materiale: për secilin nga pjesëmarrësit një kartë të kuqe, të gjelbër dhe të verdhë

Pema e frutave

Qëllimi: Vlerësim individual dhe në grup

Rrjedha: Drejtuesi vizaton mbi një pllakat të madh / apo format të madh letre një pemë me degë dhe rrënjë. Pjesëmarrësve u shpërndahen letra në formë të rrumbullakët në ngjyra të ndryshme mbi të cilat ata do të shënojnë mbresat e tyre në lidhje me seminarin/workshopin. Letrat ngjiten më pas në dhe nën pemë. Thëniet pozitive vihen në degët e pemës si fruta të pjekura, thëniet kritike vihen poshtë në bar si fruta që kanë rënë nën pemë, ndërsa sugjerimet, idetë e ndryshme etj vihen në rrënjët e pemës. Pasi të tërë të kenë shkruar dhe vendosur „mollët“ e tyre, i tërë grupi i hedh një vështrim pemës dhe bën pyetje nëse ka të tilla në lidhje me thënie të veçanta.

Grupi i synuar: duke nisur nga 12 vjeç

Materiale: Letër pllakat, letra të rrumbullakta në ngjyrë të gjelbër, të kuqe dhe të verdhë, lapsa, ngjitëse

Përshëndetje nga / drejt Evropa/ës

Qëllimi: Bërja e ditur e mbresave rreth seminarit përmes shkrimit të një kartolinë përshëndetëse nga Seminari / workshop-i

Rrjedha: Pjesëmarrësve u shpërndahen letra në formatin e kartolinave. Ata mund t'i shkruajnë apo vizatojnë ato duke reflektuar kështu përmbajtjen e seminarit apo workshop-it. Më pas kartolinat futen në një kuti dhe dërgohen në destinacione. Kutia postare zbrazet në mes të pjesëmarrësve, të cilët tërheqin të gjithë nga nja kartolinë. Këto ata ia lexojnë njëri-tjetrit, e tregojnë dhe flasin rreth saj

Koha: 30 – 45 minuta

Grupi i synuar: duke nisur nga 12 vjeç, maksimumi 15 pjesëmarrës

Materiale: Letra në madhësinë e një kartoline, lapsa me ngjyra, eventualisht edhe materiale për punë dore

Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi argëtues dhe tematik i Lojës Plan është i rëndësishëm për një mbyllje të mirë të saj. Kështu mund të sqarohen, saktësohen dhe analizohen me të vërtetë fakte politike, rrethana historike apo edhe veprime konkrete nga ana e politikanëve dhe politikaneve.

Transferimi i rezultatit të Lojës Plan në një kontekst real dhe krahasimi me situatën aktuale politike është i domosdoshëm, në mënyrë që të mos krijohen ide të gabuara e për një kohë të gjatë në mendjet e pjesëmarrësve.

Vlerësimi realizohet në disa shkallë dhe mund të bëhet ose me shkrim ose me gojë, me anë metodash të ndryshme (për shembull, prej lojtarëve dhe lojtareve kërkohet t'u përgjigjen me shkrim disa prej pyetjeve të mëposhtme).

1. Fillimisht pjesëmarrësit luten të shprehen lirisht në lidhje me rrjedhën e Lojës Plan dhe përvojat e tyre personale gjatë ditës. Në varësi nga premiset e cdo grupi drejtuesi i lojës duhet/ mund të mbështesë këtë proces me pyetje të mundshme rreth gjendjes së tyre (empati).
2. Në mbyllje – sipas numrit të pjesëmarrësve në grup – ata mund të referojnë në plenum rreth karakteristikave specifike të roleve të tyre. Në këtë mënyrë pjesëmarrësit qartësohen në lidhje me sjelljen e „bashkë-konkurrentëve“ të tyre në Lojën-Plan si dhe njëkohësisht bëhet i mundur zbulimi i interesave shpesh kontradiktore të lojtarëve. Konfliktet e mundshme mes roleve, problemet dhe pyetjet, që mund të lindin gjatë lojës, duhet të tematizohen dhe diskutohen tani. Rolet pjesërisht të huaja duhet të problematizohen. Këtu ndër të tjera duhet diskutuar në lidhje me faktin, se deri në c'masë pjesëmarrësit eventualisht nuk kanë mundur të pranojnë rolet e tyre apo deri në c'masë ata në fund të fundit kanë luajtur vetveten.
3. Vlerësimi tematik qëndron para së gjithash në bërjen të njohur të vështirësive në dinamikën e integritit në Bashkimin Evropian dhe në diskrepancat, që ekzistojnë mes interesave kombëtare dhe përgjegjësive evropiane, si dhe në diskutimin e këtyre vështirësive duke u nisur nga situata e politikanëve dhe politikaneve. Nëse struktura e grupit e lejon dhe nëse dëshirohet edhe nga pjesëmarrësit, në këtë proces mund të përdoret edhe një material thellues. Ndoshta ky diskutim përmbyllës mund të përbëjë pikënisjen për një njësi tjetër në kuadër të seminarit.

Për diskutimin përmbyllës mund të përdoren **pyetjet kyce** të mëposhtme:

- Cilat janë shanset dhe cilat janë rreziqet e zgjerimit të Bashkimit Evropian me shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë?
- Cilat janë fushat më problematike të bashkimit të Evropës në këtë kontekst?
- Cilat do të ishin konceptet e të ardhmes së zgjerimit të BE apo c'pamje do të kishte Evropa e 27+?
- Ku janë kufinj të zgjerimit të Bashkimit Evropian?

- Cfarë nënkuptojnë shtetet e vecanta me 'integrim' apo për cilat arsye duan ato që të pranohen në BE?
- Cila do të ishte mënyra e konceptimit të një BE më të madhe?
- Cilat janë epërsitë dhe cilat disavatazhet e një bashkëpunimi më intensiv në kuadër të BE?
- Cili do të ishte roli i BE së zgjeruar në arenën e politikës ndërkombëtare?
- Cili vend ka shanse për tu pranuar së shpejti në BE?
- Sa fiktiv është skenari?
- Cili do të ishte plani kohor për këtë? Po në realitet?
- C'renditje mund të pritët përsa i përket pranimi në BE? Pse?
- Cilat janë modalitetet konkrete të anëtarësimit? Cilat do të ishin adaptimet për hir të anëtarësimit?
- C'pamje do të marrin raportet mes shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve në hapësirën evropiane të detit Mesdhe?
- Cilët janë sektorët problematikë më të vështirë në vlerësimin e kapacitetit zgjerues të Bashkimit Evropian?
- A do të mbështesin njëri-tjetrin shtetet e Ballkanit Perëndimor në rastin e pranimi në Bashkimin Evropian?
- Cilat janë çështjet politike që duhen sqaruar në mënyrë urgjente përpara zgjerimit të BE nga vetë shtetet e Ballkanit Perëndimor?

Përshkrim i shkurtër – Shqipëria

Sipërfaqja:	28.748 km ²
Banorë:	3,172 Mln.
PBB/banor:	2.930 Euro US-Dollar
Rritja ekonomike:	5,0 %
Papunësia:	13,2 %

www.weltalmanach.de (2009)

Shqipëria/Albania është një shtet në Evropën Juglindore. Ajo kufizohet në veri me Kosovën, Malin e Zi, në lindje me Maqedoninë si dhe në jug me Greqinë. Kufiri natyral perëndimor krijohet nga bregdeti i detit Adriatik dhe Jon duke e bërë vendin pjesë të grupit të vendeve fqinj të Mesdheut. Vendi është anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe i Këshillit Evropian. Në datën 3 prill 2008, Shqipëria mori ftesën për anëtarësim në NATO.

Me një sipërfaqje prej 28.748, Shqipëria është diçka më e vogël se Belgjika dhe me rreth 3,2 Mln. banorë më pak e populluar se rajoni i Berlinit.

Periudha pas ndryshimeve të viteve 90-të solli me vete levizje të mëdha demografike. Nga njëra anë qindra mijëra shqiptarë emigruan legalisht dhe ilegalisht për në Itali, Greqi, vende të tjera të BE-së si dhe në Amerikën e Veriut, nga ana tjetër kryeqyteti Tirana dhe qyteti me portin më të madh, Durrësi, njohën një rritje të madhe të popullsisë si pasojë e emigrimit të brenshëm (Tirana nga 250.000 banorë në vitin 1990 numëron sot më shumë se 600.000). Në vitet në vijim shumë fshatra të tjerë do të ktheheshin në shkretëtira. Në qoftë se deri para vitit 1990 Shqipëria kishte shkallën më të lartë të lindjeve në Evropë, (mjetet parandaluese ishin të ndaluara) sot kjo është ulur duke arritur mesataren evropiane ku përllogaritet për grua më pak se dy femijë. Kjo situatë si dhe shpërnguljet e motivuara shkaktojnë një plakje të shpejtë të popullsisë shqiptare edhe pse për sa i përket brezit nga 15-30 vjeç, shumë i pranishëm, nuk është ende fort e ndjeshme.

Para Luftës së Dytë Botërore 70% e popullsisë ishte deklaruar si sunitë islame. 20% si ortodoksë të krishterë, këtu përmbledheshin edhe minoritetet etnike. Rreth 10% i përkisnin kishës katolike-romake. Shqiptarët ortodoksë jetonin pothuajse në jug, katolikët në veriperëndim ndërsa myslymanët përveç disa zonave malore jetonin kudo në vend.

Në vitin 1967 u ndalua feja në mënyrë totalitare. Shqipëria u bë shteti i parë ateist në botë. Një vit më vonë Shqipëria doli nga Këshilli i Mbështetjes Ekonomike dhe Trakstati i Varshavës duke ndjekur kursin stalinist.

Edhe pse privatizimi dhe ndërtimi i kudrit ligjor kanë shënuar hapa përpara, vazhdojnë të ekzistojnë njëkohësisht probleme strukturore të rënda: Rritja ekonomike mbështetet në rradhë të parë tek ndihma e donatorëve ndërkombëtarë, dërgesat në para të shqiptarëve me banim jashtë vendit si dhe nga ndërtimet dhe investimet me qëllim pastrimin e parasë nga burime ilegale. Rreth një e treta e popullsisë që jeton nga një ekonomi substanciale vazhdon të jetë aktive në ekonominë bujqësore e cila përbën dhe një të katërtën e Prodhimit të Brendshëm Bruto. Edhe turizmi nuk është i zhvilluar. Pothuajse gjysma e popullsisë duhet të jetojë me më pak se dy dollarë në ditë dhe sipas klasifikimit të Bankës Botërore konsiderohet si e varfër

Një ndër problemet më të mëdha në vend është infrastruktura e dobët. Pjesa më e madhe e rrugëve janë në gjëndje të keqe, furnizimi me ujë të pijshëm kufizohet vetëm

me disa orë në ditë dhe mungesa e energjisë elektrike gjatë muajve të dimrit është kthyer në rutinë. Kjo situatë largon jo vetëm investorët e huaj, por u vështirëson aktivitetin edhe sipërmarrësve të brendshëm për të arritur një prodhimtari me kosto të ulët. Gjendja u rëndua edhe më shumë pas dhjetorit 2006 me mbylljen e impiantit bërthamor Kosloduj në Bullgari: Shqipëria e cila përfiton energji vetëm nga hidrocentrale, ishte ashtu si dhe vendet fqinje e varur nga importet bullgare.

Rritja ekonomike bazohet në aktivitetin e vazhdueshëm të industrisë së ndërtimit dhe praveç kësaj edhe në aktivitetin e ndërmarrjeve të vogla dhe shërbimet. Bujqësia, industria dhe minierat kanë bërë hapa të ngadaltë për shkak të krizës energjitike, e cila pati si pasojë rrënjën e prodhimit. Me 20,7% bujqësia është përbërës domethënës i Prodhimit të Brendshëm Bruto; sektori shërbimeve me 46,4% përbën edhe pjesën kryesore i ndjekur nga ekonomia e ndërtimit me 14,3%. Industria jep kontribut me 9,7% dhe sektori i transporteve me 8,9%. Përveç kësaj të dhënat zyrtare nuk pasqyrojnë as përafërsisht shkallën e lartë të mungesës së ofertës në tregun shqiptar të punës. Kështu p.sh. anëtarët e një familjeje fermeri nuk numërohen si të papunë edhe pse një gjysëm duzine me anëtarë familjarë të rritur në moshë kultivojnë një sipërfaqe jo më të madhe se dy deri tre hektarë.

Përshkrim i shkurtër – Bosnje dhe Hercegovina

Sipërfaqja:	51.129 km ²
Banorë:	3,926 Mil.
PBB/banor:	3.230 US-Dollar
Rritja ekonomike:	6,0% (2005)
Papunësia:	31,0% (2006)

www.weltalmanach.de (2009)

Procesi i shpërbërjes së Ish-Jugosllavisë ka shkaktuar 20 vitet e fundit shumë vuajtje dhe gjakderdhje. Me ditën e shpalljes së pavarësisë së Bosnje-Hercegovinës komuniteti ndërkombëtar shpreson më në fund të hidhen pas fantazmat e të shkuarës, dhe të shihet përpara, drejt të ardhmes së paqte. Për të gjithë Ballkanin Bashkimi Evropian uron një të ardhme në paqe, stabilitet dhe prosperitet ekonomik. Të njëjtin qëllim ndiqni edhe Ju.

Objektivi më i rëndësishëm i politikës së Bosnje-Hercegovinës është përafrimi apo përfshirja në strukturat euroatlantike me qëllim anëtarësimin në BE dhe NATO.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)

Bisedimet rreth Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE mundën të mbylleshin në dhjetor 2006. MSA u siglua më 4.12.2007 dhe u nënshkrua më 16.6.2008. BE vuri si kusht për nënshkrimin e MSA një reformë të kërkuar prej kohësh në sistemin policor. Deri në atë moment forcat policore të të dy pjesëve të vendit të Republika Srpska dhe Federatës boshnjako-kroate nuk bashkëpunonin me njëra-tjetrën.

Teorikisht Marrëveshja ofron avantazhe si për vendet kandidate për anëtar të BE ashtu edhe për shtetet anëtare. Këto kanë të bëjnë veçanërisht me tregtinë, pasi parashikohet heqja graduale e doganave dhe përmes kontratave në fushën e tregtisë dhe transporteve shteti përmirëson Credit-rating e vet. Në tërësi kjo do të çonte në rritjen e investimeve të huaja. Krahas kësaj vendet kandidate për anëtarësim do të kenë më shumë akses në fondet e BE, prej të cilave mund të aplikohet për mbështetje në masë jo të vogël në zhvillimin e bujqësisë, arsimit, shëndetit shkencës apo edhe kulturës dhe artit.

Përshtatja e kuadrit ligjor të Bosnje-Hercegovinës me normat e BE – janë rreth 1200 ligje – është një ndër pjesët më të rëndësishme të Marrëveshjes. Ky adaptim duhet të realizohet në gjashtë vitet e ardhshme. Shumë politikanë në Bosnje-Hercegovinë do të përpiqen të mbrojnë interesat e tyre lokale, t'i bëjnë bisht marrëveshjes ose edhe deri ta bllokojnë atë.

Administrata e Bosnje-Hercegovines

Ndarja politike e shtetit është komplekse. Që prej Marrëveshjes së Dayton-it (njohur ndryshe si Marrëveshja e Paqes së Dayton-it) Bosnje Hercegovina përbëhet nga dy entitete: Federata e Bosnje dhe Hercegovinës (Federacija Bosne i Hercegovine, njohur ndryshe si Federata boshnjako-kroate) dhe Republika Srpska (Republika Serbe). Të dy këto entitete kanë nga një Ekzekutiv dhe Legjislativ të vetin. Federata e Bosnje dhe Hercegovinës përbëhet nga dhjetë kantone, të cilat në shumë aspekte kanë kompetencat e tyre të mëvetësishme.

Politika në Bosnje dhe Hercegovinë

Zgjedhet e datës 1 tetor 2006 u vlerësuan si të orientuara për nga e ardhmja, pasi Komuniteti Ndërkombëtar në vitin 2007 donte të largonte Përfaqësuesin e Lartë nga Bosnje dhe Hercegovina dhe ta linte vendin në pavarësinë e plotë të tij. Më pas ky projekt u shty edhe për një vit.

Gjendja ekonomike e Bosnje-Hercegovinës

Bosnje dhe Hercegovina ofron potenciale të rritjes ekonomike në sektorët ekonomikë të industrisë së energjisë elektrike (eksportuesi i vetëm i energjisë elektrike në rajon), në bujqësi (produkte bio), industrinë e përpunimit të drurit, industrinë e ndërtimit (veçanërisht infrastrukturën e qarkullimit), përpunimin e metaleve dhe turizëm.

Përshkrim i shkurtër – Kroacia

Sipërfaqja:	56 542 km ²
Banorë:	4,441 Mln.
PBB/banor:	9310 Euro US-Dollar
Rritja ekonomike:	4,8%
Papunësia:	11,6%

www.weltalmanach.de (2009)

Lufta në Kroaci filloi në vitin 1991, pas referendumit me anë të së cilit kroatët me shumicë votash kishin vendosur për pavarësi dhe pas përplasjeve midis serbve dhe kroatëve në krahinat Krajina dhe Slavonia. Në vitin 1991, Kroacia ashtu si më parë Sllovenia, u deklarua e pavarur edhe pse vendi në pjesën më të madhe të tij ishte ende i pushtuar nga ushtria jugosllave, e cila zotërohej nga serbë. Njësitë kroate luftuan edhe në Bosnjë-Hercegovinë kundër ushtrisë jugosllave. Përveç kësaj, më 1993 aty pati luftime mes kroatëve boshnjakë dhe myslimanëve. Me anë të një ofensive Kroacia mundi të merrte kontrollin në krahinat e pushtuara nga serbët vetëm në fillim të muajit gusht 1995 deri në dhjetor 1995, kur më në fund aprovoi marrëveshjen Dayton-it e cila i dha fund luftës civile në Ballkan.

Sistemi politik dhe politika e brendshme

Në politikën e brendshme të vendit ndihen qartë dhimbjet e pasluftës. Për këtë arsye, qëllimi i Qeverisë është shërimi i menjëhershëm i ekonomisë së vendit, i cili aspirohet së bashku me anëtarësimin në NATO dhe BE. Në këtë kontekst, që prej vitit 2000 Kroacia ka bërë hapa themelore edhe pse sistemi i drejtësisë është ende i prapambetur. Sidoqoftë në Kroaci është krijuar një kulturë politike me tendencë demokratike, e cila mbështetet nga ambientet e larmishme partiake, ato të shtypit si dhe nga rritja ekonomike. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit nënshkruar në vitin 2001 me BE-në, Kroacia është e detyruar brënda gjashtë vjetësh të përafroje 60 përqind të sistemit drejtësor të BE-së me sistemin drejtësor kombëtar.

Natyrisht në sektorë kyç ka ende sfida të medha, të cilat duhen kapërcyer, si:

- reforma në sistemin ligjor inefficient
- reforma në administratën publike dhe në luftën kundër korrupsionit ende të përhapur në shumë fusha.
- Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar të drejtës së minoriteteve, në radhë të parë kthimit të refugjatëve.
- Me kujdes duhet trajtuar edhe çështja e ndjekjes së kriminelëve të luftës.
- Vazhdimësia e bashkëpunimit rajonal ashtu si edhe përpjekjet për zgjidhjen e problemeve dypalëshe me vendet fqinj, veçanërisht në lidhje me vendosjen e kufijve, merr një rëndësi vendimtare.

Ekonomia e Kroacisë

Në vitet e fundit Kroacia ka shënuar suksese të konsiderueshme në ekonomi. Në vitin 2003 ekonomia u rrit me 4,5 përqind, shkalla e inflacionit u ul në 1,5 përqind duke paraqitur edhe vlerat më të mira nga gjithë vendet në transformim të Evropës Lindore. Të dhënat ekonomike janë më të mira se ato të shumë vendeve të tjera tashmë të

anëtarësuar. Megjithatë zhvillimi ekonomik vuan ende nga shkalla e lartë e papunësisë, mungesa e sistemit social dhe borxhi i lartë i shtetit çka e detyron Qeverinë të zbatojë një politikë kursimi. Në sektorin e bujqësisë dhe ndërtimit të anijeve privatizimi i ndërmarjeve ish-shtetërore ka ecur me hapa shumë të ngadalta. Përveç kësaj Kroacia duhet të luftojë edhe shkallën e lartë të korrupsionit. Mungesa e sigurisë ligjore, kostot e larta të prodhimit dhe monedha vendase e mbivlerësuar „Kuna“ e cila e ndrydh eksportin e prodhimeve kroate vlejné si fusha problematike të ekonomisë kroate.

Politika e jashtme e Kroacisë

Qëllim prioritar i politikës së jashtme të Kroacisë është integrimi sa më shpejt i mundur në BE dhe NATO. Kjo i premtion Kroacisë avantazhe ekonomike edhe në politikat e sigurisë. Për sa i përket politikave të sigurisë dhe mbrojtjes, që prej vitit 2000 Kroacia merr pjesë në programin „Partnership-for-Peace“ dhe është anëtare e grupit Vilnius „Vilnius Gruppe“ të aspirantëve për anëtarësim në NATO. Në fillim të vitit 2003 Kroacia i paraqiti Komisionit të BE-së kërkesën për anëtarësim dhe që prej korrikut 2004 është kandidat zyrtar për anëtarësim.

Marrëdhëniet me BE-në rëndohen nga ritmet e ngadalta të ekstradimit të kriminelëve të dyshuar të luftës Gjykatës së Hagës për çështjet e ish-Jugosllavisë. BE-ja e ka deklaruar bashkëpunimin me Gjykatën Penale si kusht thelbësor për anëtarësim në BE. Pranimi i planifikuar për vitin 2005 në bisedimet për anëtarësim u shtye për këtë arsye.

Një konflikt i mëtejshëm është ai me vendin fqinj, Slloveninë në lidhje me vijën e saktë kufitare detare të të dy vendeve. Ky konflikt është rënduar diçka në vitet e fundit dhe është marrë në trajtim nga Gjykata Penale Ndërkombëtare.

Në fillim të vitit 2008 u vu re që bisedimet me Kroacinë po bllokoheshin: Zona e njëanshme e peshkimit shpallur në datë 1 janar 2008 jashtë ujrave territoriale kroate rëndoi jo vetëm marrëdhëniet e Kroacisë me fqinjët e saj të BE-së, Italinë dhe Slloveninë, por edhe me BE-në vetë. Zyrtarisht Zagrebi foli për një zonë ekologjike për mbrojtjen e rezervave të peshkut në Adriatik. Njëkohësisht Kroacia hodhi pretendimin për të drejta ujore ndërkombtare përtej zonës së saj territoriale. Zona e shpallur përfshin 25.000 kilometra katror. Në lidhje me këtë, pala kroate apeloj të drejtën ndërkombëtare të sovranitetit dhe terhoqi vëmendjen se tashmë precedent për një rast të tillë në rajon ka patur – edhe Italia dhe Sllovenia kanë deklaruar një zonë të njëanshme të këtij lloji.

Përshkrim i shkurtër – Kosova

Sipërfaqja:	10.887 km ²
Banorë:	2,127 Mln.
PBB / banor:	s'ka të dhëna
Rritja ekonomike:	s'ka të dhëna
Papunësia:	35 – 50%

www.weltalmanach.de (2009)

Procesi i shpërbërjes së Ish-Jugosllavisë ka shkaktuar 20 vitet e fundit shumë vuajtje dhe gjakderdhje. Me ditën e shpalljes së pavarësisë së Bosnje-Hercegovinës komuniteti ndërkombëtar shpreson më në fund të hidhen pas fantazmat e të shkuarës, dhe të shihet përpara, drejt të ardhmes së paqte. Për të gjithë Ballkanin Bashkimi Evropian uron një të ardhme në paqe, stabilitet dhe prosperitet ekonomik. Të njëjtin qëllim ndiqni edhe Ju.

Serbët dhe shqiptarët e Kosovës kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të ndarë në lidhje me çështjen e statusit ndërkombëtar, që duhet të ketë kjo provincë. Kosova ka shpallur pavarësinë e saj, ndërsa Serbia vazhdon ta konsiderojë Kosovën si pjesë të territorit të vet. Që prej vitit 1999 Kosova është nën administrimin e Kombeve të Bashkuara. Bazë për këtë është Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, datë 10 qershor 1999. Së këtejmi u krijua Misioni i Kombeve të Bashkuara UNMIK (*United Nations Interim Administration Mission in Kosovo*). Pas ngjarjeve të luftës UNMIK mendohet të krijojë një administratë tranzitive për rivendosjen e raporteve normale jetësore.

Gjatë muajve të fundit në Kosovë ka patur ndryshime shumë të thella: pas bisedimesh shumëvjeçare, por gjithsesi të pasuksesshme, mes Serbisë dhe shqiptarëve të Kosovës në lidhje me statusin përfundimtar, më 17 shkurt 2008 Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia. 22 shtete të Bashkimit Evropian, mes të cilave edhe Gjermania, Franca, Britania e Madhe dhe Italia e kanë njohur ndërkohë pavarësinë e Kosovës. Në këtë mënyrë u mbyll ky proces i gjatë dhe i vështirë i shpërbërjes. Bashkimi Evropian shpreson që në këtë mënyrë në rajon të vendoset qetësia.

Pavarësia e Kosovës

Deri më tani marrëdhëniet me jashtë kanë qëndruar në hijen e konfliktit për njohje diplomatike. Një sërë shtetesh, mes të cilave edhe Gjermania, kanë hapur që në shkurt 2008 përfaqësitë e tyre në Prishtinë. Me përjashtim të Serbisë, të gjitha shtetet fqinje, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia, kanë lidhur marrëdhëniet diplomatike me Kosovën. Pikërisht njohja e Kosovës nga ish-Republikat jugosllave e ka zemëruar dhe njëkohësisht edhe zhgënjyer shumë Serbinë.

Brenda për brenda Jugosllavisë Kosova ishte rajoni më i varfër. Shkak për këtë – krahas prapambetjes së përgjithshme të rajonit – ishte edhe një politikë e munguar ekonomike dhe strukturore në 30 vitet e shkuara. Në Kosovë ishte vendosur kryesisht industria që prodhonte lëndë të parë dhe shumë pak industri përpunuese. Në fakt Kosova subvencionohej nga republika të tjera jugosllave, por megjithatë në vitet gjashtëdhjetë – shtatëdhjetë investicionet kapnin vetëm 50% të vlerës mesatare jugosllave.

Ekonomia

Ekonomia e Kosovës mbështetet nga njëra anë në sipërmarrje të vogla familjesh fermere – më së shumti mbillen drithëra (grurë, misër) lule dielli, kolzë, panxhar sheqeri dhe hardhi rrushi – si dhe në sipërmarrje private në sektorin e tregtisë dhe të ndërtimit. Sektori industrial karakterizohet nga fusha të tilla si minierat, kimia, elektronika, tekstilet, lëndët e ndërtimit dhe druri. Në sektorin e minierave nxirren bakër, qymyr, plumb dhe zink. Në tërësi sektori industrial ka një nivel të dobët zhvillimi.

Monedha zyrtare është euro. Mejjithatë Kosova nuk është ende vend anëtar i Komunitetit Monetar Evropian. Monedha D-Mark, vendosur dikur si monedha e dytë në vend, u vu në përdorim më 1999 nga administrata e Kombeve të Bashkuara dhe u zëvendësua më pas nga euro. Në zona me popullsi dërrmuese serbe mund të paguhet edhe me dinarë serbë.

Papunësia dhe varfëria

Momentalisht në një milionë njerëz të aftë për punë ka vetëm 325.000 vende pune (përfshirë këtu edhe ato të paregjistruar e ekonomisë informale). Krahas kësaj çdo vit i shtohen tregut të punës dhe 36000 forca të reja pune.

Vitet e fundit papunësia është e nivelit të lartë, por ka shënuar ulje të lehta (2001: 57,1%, 2002: 55%, 2003: 49,7%. Në vitin 2008 papunësia qëndron mes shifrave 42 dhe 43%. Grupmosha mes 16 dhe 24 vjeç është e prekur në një masë 60% nga papunësia. Sipas të dhënave të Bankës Botërore 37% e popullsisë jetojnë poshtë kufirit të varfërisë (të ardhurat ditore për të rritur janë poshtë 1,37 euro) ndërsa 15% poshtë kufirit të varfërisë ekstreme (të ardhurat më pak se 0,93 Euro në ditë për të rritur).

Përshkrim I shkurtër – Mali i Zi

Sipërfaqja:	13.812 km ²
Banorë:	601.000
PBB / Banor:	4.130 Euro
Rritja ekonomike:	16,1%
Papunësia:	9,0%

www.weltalmanach.de (2009)

Montenegro (serbisht: *Crna Gora*, shqip *Mali i Zi*). Shteti ballkanik me rreth 622.000 banorë (regjistrimi i popullsisë 2003: 620.145) dhe me një sipërfaqe prej 13.812 km² është një ndër shtetet më të vogla të Evropës. Kryeqyteti është Podgorica.

Mali i Zi është anëtar i Kombeve të Bashkuara, i OSBE-së dhe i Këshillit Evropian. Banorët e Malit të Zi konsiderohen si 43% malazezë, 32% serbë, rreth 8% boshnjakë, 5% shqiptarë dhe 4% myslimanë sllavë. Çështja nëse populli malazez është një popull më vete ose pjesë e popullit serb, është për vetë popullatën atje një pikë e diskutueshme; në veçanti konservatorët serbë e konsiderojnë pjesën më të madhe të Malit të Zi si pjesë përbërëse e popullit serb. Po kështu edhe tek minoritetet e mëdha, kryesisht tek ato në veri të vendit, (pjesa malazeze e Rashkës, më saktë e Sanxhakut) ku jetojnë boshnjakët dhe myslimanët sllavë, ka preferenca të ndryshme në lidhje me emërtimin e kombësisë së tyre.

Që prej viteve 1990, Mali i Zi konsiderohet si qendra ndërkombëtare e kontrabandës së cigareve. Opozita e shihet implikimin e Kryeministrit Đukanović në kontrabandë si një arsye për fushatën e tij të pavarësisë. Në lidhje me këtë, Kryeministri malazez Milo Đukanović, pas rizgjedhjes së tij në detyrë, në shkurt 2008, u vu vullneatarisht në dispozicion të hetuesëve nga Bari/Itali në fund të marsit 2008. Pyetësori përbëhej nga 80 pyetje. Me anë të të një marrëveshjeje me Gjykatën e Barit, e cila kishte vënë si kusht përgjigjen vullnetare të Đukanović, u evitua publikimi i përmbajtjes së pyetësorit. Seancat pyetësore duhet të kishin filluar që në verën e vitit të shkuar 2007, por u shlytën për në mars, atëherë kur Milo Đukanović pas tërheqjes së kolegut të tij partiak për shkaqe shëndetësore u riemërua Kryeminister.

Ende sot Mali i Zi trajton në vazhdimësi çështje mbi kontrabandën e cigareve, lëndëve narkotike, armëve, mishit të bardhë, automjeteve të vjedhura nga vendet e BE-së dhe vrasjet me pagesë të pazgjdhshme të krimit të organizuar. Si shembull për këtë shërben vrasja e pashpjegueshme e Duško Jovanović, kryeredaktorit të gazetës *Dan* me nota kritike ndaj Qeverisë, i cili u qëllua natën e 24-25 majit 2004. Hetimet kundër kryetëdyshuarit u mbyllën për mungesë provash.

Pasuritë minerale më të rëndësishme janë boksiti, minerale hekuri dhe linj; në industri sektorët më të rëndësishëm të prodhimit janë tabaku, alumini, përpunimi i kripës. Ekonomia bujqësore përbëhet nga kultivimi i perimeve, drithrave, patates, tabakut, verës, agrumeve, ullinjëve dhe i fiqve. Përveç këtyre fushave, rol të madh në Malin e Zi luan edhe turizmi. 15% e Prodhimit të Brendshëm Bruto sigurohet nga ky sektor; sipas World Travel & Tourism Council (WTTC), Mali i Zi është prej vitesh një ndër tre vendet turistike me rritje më të madhe kudo në botë.

Në vitin 1999 u fut si monedhë marka gjermane. Në vijim të zëvendësimit të markës gjermane me euron, që prej vitit 2002 shërben euro si monedhë vendase. Duke qënë se vendi nuk merr pjesë në Bashkimin Monetar Evropian nuk ka të drejtën e shtypjes së monedhës së vet euro. Në fund të vitit 2005 u publikuan pullat e para që pas vitit 1913.

Përshkrim i shkurtër Maqedonia

Sipërfaqja:	25 713 km ²
Banorë:	2,036 Mil.
PBB / Banor:	3070 Euro US-Dollar
Rritja ekonomike:	3,0%
Papunësia:	35%

www.weltalmanach.de (2009)

Maqedonia është një shtet kontinental i cili në veri kufizohet me Serbinë dhe Kosovën, në lindje me Bullgarinë, në jug me Greqinë dhe në perëndim me Shqipërinë. Maqedonia ka qenë republika më jugore e ish-Jugosllavisë dhe e shpalli pavarësinë e vet në vitin 1991, pak më vonë se Kroacia dhe Sllovenia.

Gjuha e shumicës së popullsisë është maqedonishtja, ndërsa gjuha me numrin e dytë më të madh të folësve të gjuhës së vet amtare është shqipja. Krahas kësaj në rajone të caktuara flitet edhe turqisht, serbisht dhe gjuha e romëve. Por shumë romë kanë marrë edhe gjuhën e zonës përkatës ku jetojnë.

Shteti dhe politika

Forma shtetërore e Maqedonisë përcaktuar me Kushtetutën Maqedonase të vitit 1991 është Republikë me qeverisje në formën e një demokracie parlamentare. Sistemi i partive maqedonase karakterizohet nga një polaritet i dyfishtë: një etniko- kombëtar (sllavo-maqedonas dhe shqiptarë) dhe një politik (postkomunist dhe antikomunist).

Marrëdhëniet me fqinjët

Për shkak të debatit mbi emrin, Greqia u bë pengesë në prill të vitit 2008, që Maqedonia të merrte premtimin për anëtarësimin e dëshiruar në NATO. Politika e jashtme e Maqedonisë karakterizohet fuqishëm nga përpjekjet për t'u bërë anëtar i NATO dhe BE. Por vendi fqinj, Greqia, është kundër pranimit të Maqedonisë nën emrin Republika e Maqedonisë.

Bullgaria ka qenë vendi i parë që ka njohur pavarësinë e Maqedonisë më 15 janar 1992 dhe pikërisht me emrin e vet kushtetues. Por Bullgaria nuk ka pranuar të njohë për një kohë të gjatë ekzistencën e një kombi maqedonas dhe një gjuhe maqedonase të ndarë, gjë që çoi në disa komplikacione gjatë nënshkrimit të marrëveshjes mes dy vendeve.

Serbia e sheh në mënyrë kritike fqinjin e saj jugor, pasi Maqedonia u shkëput nga Jugosllavia dhe gjatë konfliktit me Kosovën ka qëndruar në anë të NATO-s. Maqedonia ka njohur pavarësinë e Kosovës në vjeshtën e vitit 2008 së bashku me Malin e Zi. Për shkak të këtyre rrethanave politika maqedonase synon para së gjithash qetësimin e situatave.

Anëtarësimet e synuara në NATO dhe BE janë temat kryesore të politikës së jashtme në Maqedoni.

Në vitin 2004 hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE.

Maqedonia ishte një ndër zonat më të prapambetura në ish-Jugosllavi më një industri të zhvilluar shumë pak dhe me pasuri të pakta lëndësh të para. Në vitin 2000 9,7% e PBB

vinin nga bujqësia dhe vetëm 31,6% në industri. Kuota e papunësisë me vlerën e pandryshuar prej 35% ishte në një nivel shqetësues. Maqedonia vazhdon të jetë një prej vendeve më të varfra të Evropës.

Situata ekonomike

Vendi vuan problemet tipike të një shteti postsocialist si p.sh korrupsion i theksuar, strukturë e tejfryrë nëpunësish dhe ineficiencë e ndërmarrjeve industriale (pjesërisht ende shtetërore). Ekonomia informale në Maqedoni përbën der 45% të PBB.

Papunësia ende shumë e lartë paraqet një prej problemeve kryesore ekonomike. Deficiti i bilancit tregtar është i lartë, importet i tejkalojnë eksportet në një masë prej më shumë se 70%. Ky disproporcion kompensohet vetëm nga transfertat e parave të maqedonasve që jetojnë jashtë vendit.

Ekskurs: Disputi rreth emrit kushtetues „Republika e Maqedonisë“ filloi me shpalljen e pavarësisë së Maqedonisë në vitin 1991 dhe zgjat edhe sot e kësaj dite. Fillimisht Athina kishte frikën e pretendimeve territoriale të Shkupit në lidhje me provincën greke të Maqedonisë. Njohja ndërkombëtare e shtetit të ri vonoi deri në vitin 1993, kur Kombet e Bashkuara e pranuan me emrin FYROM. Në shkurt të vitit 1994 nën drejtimin e kryeministrit Andreas Papandreou Greqia vendosi embargon e tregtisë kundër Maqedonisë.

Në vitin 1995 konflikti nisi të lëvizte. Falë ndërmjetësuesve ndërkombëtarë Cyrus Vance dhe Lord Owen në Shkup dhe Athinë u nënshkrua një marrëveshje interim. Sipas kësaj marrëveshjeje – e cila që prej 2002 nuk është më e vlefshme – Maqedonia ndryshoi flamurin e vet shtetëror: ai nuk tregon me „yllin e Vergina-s“, por një diell të stilizuar. Fillimisht Maqedonia e plotësoi Kushtetutën e vet me tre pasazhe, ku ajo hiqte dorë nga pretendimet territoriale përkundërt fqinjëve të saj, nuk do të përzihej në punët e brendshme të tyre dhe në rast të ndryshimit të kufijve, këtë do ta bënte gjithsesi në përputhje me normat ndërkombëtare.

Një zgjidhje e mundshme u propozua nga OJQ e Brukselit "International Crisis Group" (ICG). ICG listoi tre elemente kyçe, që do të mundësonin një bashkim të të dyja palëve pa u dashur që të humbisnin fytyrën. Kështu parashikohej një marrëveshje mes Maqedonisë dhe Greqisë, që i jep të drejtën Greqisë të përdorë për fqinjin e vet termin „Maqedonia e Sipërme“ ose një formulë tjetër të përbërë. Njëkohësisht sipërmarrjet e të dy shteteve lejohet të mbajnë emrin e Maqedonisë për produkte apo shërbime të realizuara në territoret përkatëse. Ndërsa Maqedonia do të njihet nga komuniteti ndërkombëtar me emrin kushtetues „Republika e Maqedonisë“ ("Republika Makedonija").

Përshkrim i shkurtër – Serbia

Sipërfaqja:	77.474 km ²
Banorë:	7,439 Mln.
PBB/banor:	4.030 Euro US-Dollar
Rritja ekonomike:	5,7%
Papunësia:	18,8%

www.weltalmanach.de (2009)

Historia e vonë e Serbisë karakterizohet nga roli i saj si shteti më i madh i ish-Jugosllavisë. Qeveria synon anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe NATO. Me një rritje ekonomike vjetore prej 5% deri 10%, si dhe para së gjithash me investimet e huaja në rritje si pasojë e përpjekjeve të Serbisë për t'u anëtarësuar në BE, ekonomia e Serbisë vlerësohet si ajo me ritmet më të shpejta të rritjes në të gjithë rajonin.

Politika dhe administrata

Serbia është një republikë parlamentare me një parlament një-dhomësh, *Narodna Skupština* (përkthimi: Asamble Kombëtare) me 250 deputetë. Presidenti zgjidhet çdo katër vjet drejtpërsëdrejti nga populli. Edhe rizgjedhja është e mundshme. Këtë post e mban që prej vitit 2004 [Boris Tadić](#) (DS), i cili më 3 shkurt 2008 u rizgjedh për një mandat të dytë. Në Vojvodinë vazhdon të ketë një parlament rajonal. Ndërsa qeveritë rajonale të Okruzit serb emërohen nga qeveria.

Historia e re e Serbisë në rrugën e saj drejt BE

Bisedimet rreth MSA, nisur më 8 nëntor 2005 mes BE dhe lidhjes ende ekzistuese të shteteve Serbi-Mal i Zi, u ndërpre në fillimisht nga BE në pranverën e vitit 2006, pasi sipas gjykimit të BE qeveria e Beogradit nuk ishte përpjekur sa duhej për të kapur kriminelët e luftës në kërkim, Radovan Karadzic dhe Ratko Mladic. Pas përmirësimit të bashkëpunimit të Serbisë me Gjykatën Ndërkombëtare Penale për Ish-Jugosllavinë bisedimet vijuan më tej duke përfunduar më 7 nëntor 2007 me parafimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Por kjo marrëveshje duhet të nënshkruhet vetëm pasi Karadzic dhe Mladic t'i jenë dorëzuar.

Situata ekonomike e Serbisë

Një pjesë e mirë e valutës së hyrë në Serbi prej dekadash vjen nga serbët që jetojnë jashtë vendit, janë ndër të tjera të ardhura nga sektori i turizmit, investimet e vogla, aty këtu investime të mëdha në vend në kuadër projektesh të ndryshme ose si mbështetje për familjet e tyre. Këto përbëjnë rreth 3,5 miliardë US Dollarë në vit. Serbia bën pjesë në ato vende që aplikojnë një (*flat tax*). Rreth 40% e të gjithë sipërfaqes së Serbisë është e shfrytëzueshme për bujqësi. Bujqësia përbën rreth 16,6% të Produktit të Brendshëm Bruto. Sipas statistikave të vitit 2002 rreth 30% e mbarë popullsisë punojnë në bujqësi.

Sektori industrial i vendit është prej vitesh në rritje. Pjesa më e madhe e sipërmarrjeve në Serbi kanë qenë shtetërore.

Ekskurs: Procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë nis në vitin 1991, të gjitha ish-republikat deklaruan njëra pas tjetrës pavarësinë e tyre, përveç Serbisë dhe Malit të Zi. Pas kësaj më 27 prill 1992 Serbia dhe Mali i Zi formuan Republikën Federale të Jugosllavisë. Kjo lidhje në fakt nuk u njoh si pasuesi i vetëm i përligjur juridikisht i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, por mund të vijonte kështu anëtarësimin e Jugosllavisë në Kombet e Bashkuara.

Me shkëputjen e Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnje-Hercegovinës shpërtheu lufta në Jugosllavi. Fillimisht ndërhyri Ushtria Popullore Jugosllave, e cila komandohej nga Beogradi. Por pas njohjes ndërkombëtare të Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnjes, ajo duhej të largohej nga këto territore tanimë jo jugosllave. Serbia mbështeti ushtarakisht dhe financiarisht paramilitarët serbë në zonat e luftës në Kroaci dhe Bosnje, por e ndërpreu këtë mbështetje në momentin kur OKB mori vendimin për një embargo tregtie kundër Republikës Federale të jugosllavisë.

Shkaktarët e sanksioneve ishin spastrimet tanimë të njohura etnike kundër muslimanëve boshnjakë. Duke patur ndihmën e Serbisë, serbët e Bosnjës dhe Kroacisë kishin mundur të fitonin zona të konsiderueshme. Por pjesën më të madhe të këtyre zonave e humbën sërish gjatë luftës. Gjatë operacionit ushtarak kroat Oluja në gusht 1995 u dëbuan rreth 200.000 serbë kroatë, ndër të cilët edhe ushtria e mundur e Republikës Serbe [Krajina](#). Kur ushtria kroate dhe forcat e armatosura boshnja përparuan në drejtim të Bosnjes, pati edhe një numër shumë të madh serbësh boshnjakë që u larguan drejt republikës Federale të Kjugosllavisë apo në vende të treta dhe pjesërisht ndodhen atje edhe sot e kësaj dite.

Pas Marrëveshjes së Dayton-it, e cila i dha fund luftës civile në Bosnje-Hercegovinë dhe pas fundit të Krajina-s, statusi i provincës së Kosovës, populluar më së shumti nga shqiptarë, mbeti pas vitit 1995 çështja e fundit politike konfliktuale në luftrat për shpërbërjen e Jugosllavisë. Për të gjithë udhëheqësit e shqiptarëve pavarësia nga Serbia ishte kërkesa politike kryesore. Amnesty International, në raportin e vitit 1996 tërhoqi vëmendjen në lidhje me situatën delikate të të drejtave të njeriut në Kosovë. Trazirave gjithnjë e më të dhunshme në Kosovë udhëheqja serbe nën drejtimin e Slobodan Miloseciv përpëriqej t'u jepte fund me mjete policore e në fund edhe ushtarake.

UÇK (Ushtria Çlirimtare e Kosovës), e cila operonte me mjete terroriste ,filloi në vitin 1996 të sulmonte fuqishëm forcat serbe të sigurisë. Krahas kësaj pati edhe aksione të dhunshme ndaj popullksisë civile serbe në qytete. Me pajisjen e UÇK nga rezervat e armëve të Ushtrisë Shqiptare, ku pas trazirave të firmave piramidale rendi publik u shkatërrua tërësisht dhe depo të tëra municionesh u grabitën. Ky kurs konfrontimi me forcat serbe të sigurisë u përforcua më tej, gjë të cilës iu kundërvu partia e Ibrahim Rugovës.

Pas zgjedhjeve të Presidentit Serb në vitin 1997, të cilat u bojkotuan pothuajse hermetikisht nga shqiptarët e Kosovës, situata vazhdoi të përshkallëzohej. Pas një aktiviteti të intensifikuar të UÇK, e cila gjatë vitit 1998 kishte mundur të merrte kontrollin mbi rajonin e Drenicës, forcat serbe të sigurisë nisën një kundërofensivë policore të koordinuar, e cila u mbështet nga njësi të ushtrisë dhe që u mbyll me mundjen e njësisve të UÇK në rajonin e Drenicës.

Pas rindezjes së përlëshjeve në pranverën e vitit 1999 NATO, nën drejtimin e SHBA, u përpoq t'i impononte udhëheqjes serbe marrëveshjen e lidhur në Rambouillet të Francës, e cila në një aneks të fshehtë ushtarak përmbante pushtimin e Republikës Federale të Jugosllavisë nga trupat e NATO-s, gjë që për qeverinë serbe ishte tërësisht e papranueshme. Refuzimin e ultimatimit të pushtimit të Jugosllavisë NATO e interpretoi si *Casus Belli* dhe duke nisur nga data 24 mars 1999 avionët e aleancës perëndimore ushtarake bombarduan për 78 ditë të gjithë Republikën Federale të Jugosllavisë.

Sulmi ajror i nisur pa mandatin e OKB, cilësuar si një luftë humanitare, kishte për qëllim pushtimin e dhunshëm të një pjese të Serbisë. Shkelja e sovranitetit territorial të një vendi si dhe ndërhyrja ushtarake e alenacës ushtarake perëndimore e realizuar pa mandatin e OKB përbën për një pjesë të specialistëve të të drejtës ndërkombëtare një shkelje të kësaj të drejte, ndërsa për të tjerë është e legjitimuar nga e drejta për ndihmë.

Situata e shqiptarëve të Kosovës ndërkohë u përkeqësua, pasi serbët, ndryshe nga ç'pritej nuk u tërhoqën menjëherë nga territori. Nën tryshninë e bombardimeve qeveria jugosllave miratoi Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe nënshkroi *Marrëveshjen e Kumanovës*.

Në datën 17 gusht 2004 Asambleja Kombëtare Serbe propozoi njëzëri si simbole kombëtare flamurin e hershëm mbretëror dhe himnin Boze Pravde të shek. XIX, por kjo vetëm për një periudhë të përkohshme, derisa të caktohej një zgjidhje përfundimtare. Himni dhe flamuri nga koha e Monarkisë serbe duhet të zëvendësonin simbolet e fundit komuniste. Flamuri tregon një shqiponjë të argjendtë dykokëshe, një kryq të argjendtë dhe një kurore.

Përshkrim i shkurtër – Turqia

Sipërfaqja:	779.000 km ²
Banorë:	72,975 Mln.
PBB / banor:	5.400 US-Dollar
Rritja ekonomike	6,1%
Papunësia:	9,9%

www.weltalmanach.de (2009)

Historia e Turqisë si shtet republikan filloi në vitin 1923. Me një sërë aksionesh të dhunëshme revolucionare kulturore, Mustafa Qemal „Ataturk“ u mundua të krijonte një shtet modern sipas shembullit perëndimor. Koncepti „Kemalizmus“ u kristalizua përgjatë kësaj në gjashtë principe, të cilat u bënë pjesë e programit të partisë shtet „Partia Popullore Republikane“ (CHP), themeluar nga Ataturku në vitin 1943. Ato janë: Nacionalizmi (krijimi i një shteti kombëtar turk), Shekullarizimi (Laicizmi, d.m.th. ndarja e shtetit nga feja dhe shkëputja nga ideja e Pernadorisë Islamike), Republikanizmi (zgjedhja e formës qeverisëse republikane dhe anulimi i rivendosjes së sundimit sulltanor dhe kalifat), Populizmi (barazi e qytetarëve pa dallim përkatësie popullore, gjuhe dhe besimi njëkohësisht „vullneti i popullit“ duhet të njihej si element konstruktiv i shtetit turk), Etatizmi (rol i përcaktuar i shtetit në ekonomi), Reformizmi (postulat i një shëndrrimi dinamik permanent i shtetit dhe shoqërisë).

Që prej reformave të Ataturkut, Turqia zhvillon një proces rorientimi i cili është aq përfshirës, radikal dhe – megjithë rrëniat ekonomike- aq i qëndrueshëm sa në asnjë vend tjetër islamik. Përpjekja e integritimit në Evropën Perëndimore shoqërohet ende sot me masa demokratike siç ishte edhe ajo e gushtit 2002 në lidhje me ndryshimet në Kushtetutë.

Kodi i ri civil që hyri në fuqi më 1 janar 2002 shënoi një kthesë në përpjekjet e Turqisë për përshtatjen me standartet e BE-së, pasi në këtë kod u ndërmorën ndryshime domethënëse nga fusha e barazisë së të drejtave, mbrojtja e fëmijëve dhe pjesës së dobët të shoqërisë si dhe lirisë së bashkimit.

Për sa i përket reformave politike të vitit 2007 sukseset kanë qënë të pakta.

- Hapa të mëdha përpara duhen bërë në lirinë e fjalës dhe të drejtave të komuniteteve jo myslymane.
- Përpjekje të tjera shtesë janë të nevojshme në sektorin e luftës kundër korrupsionit, në sistemin e drejtësisë, të drejtat për sindikatat, për fëmijët dhe gratë, për të drejtat kulturore si dhe në sektorin e kontrollit civil mbi forcat e sigurimit.
- Qeveria e re duhet të aktivizohet pa humbur kohë në këto sektorë prioritarë.
- Në lidhje me çështjet më urgjente, pikërisht me lirinë e mendimit dhe lirinë e fesë, Qeveria duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershëm.
- Sulmet terroriste të PKK-së e cila ndodhet në listën e organizatave terroriste të BE-së, janë rritur në numër. Ka një domethënje vendimtare fakti, që Turqia dhe Iraku përmes një bashkëpunimi të zyrave përkatëse të mund t'a trajtojnë këtë problem në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.
- Turqia duhet t'i gjejë zgjidhje problemeve serioze ekonomike dhe sociale në juglindje të vendit. Përveç kësaj Turqia ka ruajtur kufizimet e lidhjeve direkte të qarkullimit me Qipron.

Ekonomia

Në vitin 2002 dhe 2003 ekonomia filloi të merrte veten nga recesioni i vitit 2001. Motor i zhvillimit ekonomik ishin në rradhë të parë eksportet edhe rimbushja e rezervave. Kërkesa e brendshme ka filluar që prej pak kohësh të tërheqë përsëri dhe trysnia e inflacionit ka rrënë.

Interesi real i përqindjes vazhdon të jetë i lartë dhe papunësia është rritur, në tremujorin e dytë të vitit 2003, 9,3 përqind më shumë se një vit më parë.

Shkalla e papunësisë lëviz midis 13,2 përqind në zonat urbane dhe 6,3 përqind në zonat rurale. Papunësia tek moshat e reja është rritur me 20 përqind. Edhe pse në vitet e shkuara diferenca e pagave u ashpërsua ndjeshëm u mundësua zbutja e stabilizimit absolut të varfërisë.

Marrëdhënjet midis Bashkimit Evropian dhe Turqisë

Me pranimin e Qipros në BE marrëdhënia armiqsore historike midis Turqisë dhe Greqisë nuk është përmirësuar. Mosmarrëveshjet në lidhje me kufirin në zonën detare si dhe pikëpamjet e kundërta për sa i përket ishullit të Qipros (pjesa jugore greke e Qipros është anëtarësuar në BE në vitin 2004, pjesa veriore republikane njihet vetëm nga Turqia dhe mbrohet nga trupat turke) i rëndojnë marrëdhëniet. Përafrimi i Turqisë me BE-në vë si kusht edhe qëndrimin konstruktiv të Ankarasë përballë çështjes së Qipros. Kushti i BE-së për fillimin e bisedimeve për njohjen nga ana e Turqisë së pjesës greke të Qipros si shtet, nuk është realizuar ende. Megjithatë duhet marrë parasysh se ribashkimi i ishullit i këshilluar nga OKB-ja dështoi jo për shkak të qipriotëve turq por nga vota negative e qipriotëve grekë.